# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/218
Datë: 28.08.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 gusht 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Kooperativat Bujqësore.

2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

# KONCEPT DOKUMENTI PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE

Prishtinë 2024

# PËRMBAJTJA


Hyrje ..... 3

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit ..... 5

- Prodhimtaria bimore ..... 11
  - Drithërat ..... 12
  - Perimet ..... 13
  - Pemët ..... 17
  - Verërat ..... 21
- Madhësia e fermës ..... 21
- Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore ..... 24
- Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet ..... 29
- Palët me interes ..... 37
- Praktikat e vendeve të rajonit ..... 39

Kapitulli 2: Objektivat ..... 50

Kapitulli 3: Opsionet ..... 51

- Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim ..... 52
- Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit ..... 52
- Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë, ndryshimi i politikës ekzistuese ..... 53

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ..... 60

- Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave ..... 65

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ..... 66

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ..... 67

- Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ..... 68
- Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet ..... 81

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ..... 82

- Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ..... 92
  - Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ..... 93
  - Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore ..... 96
  - Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ..... 100
  - Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ..... 103

## Hyrje

Koncept dokumenti për kooperativat bujqësore është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve Nr. 95/2018 të datës 21/03/2018 dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qeverisë.

Shumica e fermave në Kosovë janë ferma të vogla familjare, numri më i madh i të cilave funksionojnë në nivel të prodhimit për mbijetese, duke prodhuar të mira dhe shërbime vetëm sa për të plotësuar nevojat familjare (konsum vetanak).

Si pasojë këto ferma gjenerojnë pak të mira materiale që të plotësojnë nevojat vetanake. Për më tepër ekziston një iniciativë e vogël që të tejkalohet kjo gjendje, sepse këtyre fermave u mungon qasja në kredi dhe shërbime të tjera të biznesit. Si rezultat i kësaj varfëria ekstreme dhe e përgjithshme në Kosovë është më e larta në këtë mjedis të popullsisë.

Duke njohur këtë nevojë dhe rëndësinë e krijimit të strukturave të reja organizative për të ndihmuar fermerët në furnizimin me inpute bujqësore si dhe në mënyrën që kjo të ndihmojë në prodhim, marketing dhe qasje në financa, MPBZHR ka marr iniciativë qe të hartojë Koncept Dokumentin për Kooperativa Bujqësore përmes, të cilit mendojmë qe fermerët të organizohen dhe te kenë mundësi te jenë konkurrent në tregun global.

Qëllimi i MBPZHR-ës është që duke mobilizuar fermerët në kooperativa bujqësore të kontribuojë në rritjen ekonomike, reduktimin e papunësisë si dhe zvogëlimin e varfërisë në sektorin bujqësor në Kosovë.

Organizimi i kooperativave bujqësore do të ketë rëndësi veçantë për fermerët (anëtarë) me ndikim direkt në mirëqenien sociale të tyre, si dhe ndikim në zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme me ndikim ekonomik në nivel vendi, çdo herë duke pasur parasysh funksionimin normal dhe bashkëpunues në mes anëtarëve të tyre kooperant.

Legjislacioni për kooperativat bujqësore në Kosovë është hartuar në vitin 2003, ku është aprovuar Ligji Nr. 2003/9, i cili ndërkohë ka pësuar dy herë ndryshime dhe plotësime dhe ate me Ligjin nr. 03/L-004 me të cili përveç tjerash janë ndryshuar dispozitat ndëshkimore dhe numri i minimal i bujqëve që nevojitet për themelimin e kooperativës nga 10 në 5 bujq dhe Ligji nr.08/l-095 me të cilin janë ndryshuar dhe plotësuar dispozitat ndëshkimore, por jo edhe në aspektet tjera përmbajtsorë, po ashtu ligji aktual i përket kohës së institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse, prandaj ndryshimi i tij është i domosdoshëm. Për zbatimin e këtij ligji janë nxjerr dy Udhëzime Administrative: U/A Nr. 06/2004 për përmbajtjen e statutit dhe kushtet e regjistrimit të kooperativave të bujqve dhe U/A Nr.10/2004 për Federatën e kooperativave të bujqve të Kosovës, por të cilat nuk përmbushin nevojat dinamike aktuale për funksionimin e kooperativave bujqësore në Kosovë.

Në Republikën e Kosovës, sipas të dhënave nga regjistri i ARBK-së janë gjithsej gjashtëdhjetë e një (61) kooperativa të regjistruara për aktivitete bujqësore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka hartuar këtë koncept dokument (KD), në të cilin janë identifikuar dhe analizuar mangësitë e legjislacionit aktual, të cilat kanë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të kooperativave.

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për Kooperativat Bujqësore |
| Ministria bartëse | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br>Departamenti i Shërbimeve Këshilluese & Teknike |
| Personi kontaktues | Tahir Halitaj – Udhëheqës i Divizionit për Informim Bashkëpunim Monitorim dhe Trajnim - DSHKT |
| Plani Kombëtar për Zhvillim | **Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:**<br>- **1.8 Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi**<br>- **Masa Strategjike: Zhvillimi i bizneseve të zonave rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale**<br>- **Aktivititeti– Hartimi i Koncept Dokumentit për Kooperativat Bujqësore** |
| Prioriteti strategjik | • **Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025**<br>**2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural**<br>**2.10. 2 Rritja e konkurrencës në sektorit agro-ushqimor**<br>• **Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030**<br>**Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik**<br>**Qëllimi Zhvillimor: Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi;**<br>**Qëllimi Strategjik: Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë;** |

| | |
|---|---|
| | **Objektivi Strategjik:**<br><br>**Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë përmes organizimit të fermerëve në kooperativa bujqësore duke e përmirësuar pozitën e tyre përmes qasjes në tregjet e reja, inpute dhe mekanizim bujqësore, si dhe trajnime profesionale.**<br><br>**Objektivat Specifike:**<br>• **Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative për Kooperativat Bujqësore;**<br>• **Mbështetja institucionale për organizimin e fermerëve për tu anëtarësuar në kooperativa bujqësore;**<br>• **Menaxhimi i kooperativës bujqësore dhe bashkëpunimi me fermerë;**<br>• **Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e Kooperativave Bujqësore;**<br>• **Ngritja e kapaciteteve për palët e interesuara të kooperativave bujqësore;** |
| Grupi punues | Me Vendimin Nr.501, Ref. ZSP 613/23 i datës 23.06.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së emëron Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Kooperativat Bujqësore: Ahmet Zejnullahu - kryesues; Tahir Halitaj - anëtar; Arian Bugari - anëtar; Skender Bajrami – anëtar; Fisnik Sadikaj – anëtar; Nehar Qengaj - anëtar; Fatmire Mirena - anëtare; Bajram Seferaj - anëtar; Naser Krasniqi - anëtar; Arton Bekolli - anëtar; Luarza Muhadri – anëtare; Leonora Arifi - anëtare; Nesim Morina - anëtar; Jehona Shkodra - anëtare dhe Faton Nagavci - anëtar. |

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Koncept Dokumenti ka për qëllim të adresojë çështjet, të cilat nuk janë të përfshira në legjislacionin aktual për kooperativat bujqësore.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë, si bazë kryesore për arritjen e një prej synimeve strategjike të përcaktuara nga qeveria – rritja e konkurrencës në sektorit agro-ushqimor, e cila pothuajse është e pa mundur pa organizimin e kooperativave bujqësore.

Kooperativat janë pjesë e rëndësishme në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, andaj organizimi gradual i fermerëve përmes anëtarësimit të tyre në kooperativa do të mundësojë ruajtjen, respektivisht rritjen e prodhimit të produkteve bujqësore vendore për t'i përmirësuar kushtet ekonomike dhe sociale të fermerëve në zonat rurale.

Koncepti dhe ideja për zhvillimin e kooperativave bujqësore në Republikën e Kosovës do të realizohet për të arritur qëllimet e lartpërmendura dhe për të përcaktuar një politikë strategjike për vendin, e cila do t'i përfshijë detyrat dhe synimet për përmirësimin e sektorit, drejtimet e zhvillimit për sektorë të ndryshëm të bujqësisë në vendin tonë.

### 1.1. Korniza e politikave dhe e legjislacionit ekzistues në Kosovë

Në Republikën e Kosovës ekziston një kornizë e gjerë e dokumenteve të politikave të sektorit të bujqësisë dhe e legjislacionit të kooperativave dhe bujqësisë e zhvillimit rural që ndërlidhet me kooperativat. Kjo kornizë ligjore, e cila është objekt i trajtimit edhe në tabelën e mëposhtme, përbëhet nga aktet ligjore si në vijim:

1. Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028;
2. Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027;
3. Plani Strategjik i Sistemit Këshillimor të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027;
4. Ligji Nr. 2003/9, për Kooperativat e Bujqve;
5. Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
6. Ligji Nr. 04/l-074 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
7. Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore;
8. Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare;
9. Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;
10. Udhëzimi Administrativ nr. 06/2004 për përmbajtjen e statutit dhe kushtet e regjistrimit të kooperativave të bujqve;
11. Udhëzimi Administrativ nr. 10/2004 për Federatën e kooperativave të bujqve të Kosovës;

Këtu trajtohen edhe akte ligjore të cilat nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me kooperativat bujqësore, por që konsiderohen si akte ligjore potencialisht të ndërlidhura me themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore.

Gjithashtu është trajtuar edhe legjislacioni i BE-së që ka të bëjë me kooperativat si:

- Direktiva e Këshillit 2003/72/EC e dt. 22 korrik 2003 për zbatimin e Statutit të Shoqërisë Evropiane të Kooperativave
- Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1435/2003 e dt. 22 korrik 2003 për Statutin e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave

### 1.2. Ligji për kooperativat e bujqve- Mangësitë

Legjislacioni i Republikë së Kosovës për kooperativa bujqësore përfshinë:

- Ligji Nr. 2003/9 për Kooperativat e Bujqve, Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr.17 e dt. 01 tetor 2007;
- Ligjin nr. 03/L-004 me të cilin përveq tjerash janë ndryshuar dispozitat ndëshkimore dhe numri i minimal i bujqëve që nevojitet për themelimin e kooperativës nga 10 në 5 bujq;
- Ligji nr.08/l-095 me të cilin janë ndryshuar dhe plotësuar dispozitat ndëshkimore (Ligji nr.08/l-095), por jo edhe në aspektet tjera përmbajtjesore.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2004 për përmbajtjen e statutit dhe kushtet e regjistrimit të kooperativave të bujqve;
- Udhëzimi Administrativ nr. 10/2004 për Federatën e kooperativave të bujqve të Kosovës.

**Statusi dhe numri i minimal i bujqve**

Ligji e përkufizon Kooperativën e Bujqve si entitet ligjor të krijuar nga personat fizikë apo juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar. Kooperativa ofron shërbime për anëtarët e saj dhe nuk bazohet në krijimin e fitimit për vete. Së paku 75% i qarkullimit bruto të Kooperativës rrjedh prej aktiviteteve me anëtarët.

Kooperativa e Bujqve themelohet nga së paku dhjetë (10) bujq, që janë nënshkrues të detyrimeve, ndërsa me ligjin Nr. 03/L-004 për ndryshim dhe plotësim të ligjit bazë, ky numër zvogëlohet në pesë (5) bujq. Kooperativa e Bujqve do të ketë të drejtat dhe detyrat e personit juridik pavarësisht nga anëtarët e saj. Ajo ka pronën e saj dhe detyrat e caktuara.

**Aktivitetet:**

- Furnizimi me inpute dhe makineri të domosdoshme për aktivitete bujqësore të anëtarëve të saj;
- Grumbullimi i prodhimeve prej anëtarëve të saj, për t'i shitur në gjendje natyrore ose pas përpunimit;
- Në të mirë të anëtarëve të saj, kryen shërbimet e domosdoshme për aktivitetet e tyre bujqësore;
- Blerja e makinerisë për përdorim të përbashkët nga anëtarët e saj për nevojat e tyre bujqësore; dhe
- Në përgjithësi, në emër të anëtarëve të saj përmbush aktivitete që zgjerojnë aktivitetet e tyre bujqësore dhe vetëm për qëllime të aktiviteteve bujqësore.
- Regjistrimi në zyrën e regjistrimit të subjekteve juridike (Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë).

**Kapitali**

Kontributi Aksionar mund të jetë në para të gatshme apo në natyrë i cili mund të jetë i ndryshueshëm. Kontributi në natyrë vlerësohet në vlerë financiare. Kontributi i anëtarëve merr formën e aksioneve dhe vlera minimale e një aksioni është 10 euro.

Ligji i ri duhet të japë sinjale të qarta se kooperativa bujqësore e propozuar është e ndryshme nga ish-kooperativat e krijuara në sistemin socialist. Për ta bërë të qartë, ligji i ri duhet të përcaktojë pa mëdyshje se anëtarësimi në një kooperativë bujqësore është vullnetar dhe se anëtarët nuk mund të detyrohen t'ua dorëzojnë pronat e tyre kooperativave, përveç nëse kjo është rënë dakord sipas statutit te koperativës. Arsyeja e pjesëmarrjes vullnetare në çdo kooperativë qëndron në parimin ndërkombëtar të kooperativës n. 1. Anëtarësimi vullnetar dhe i hapur.

Kapitali i kooperativës nuk mund të zvogëlohet nën nivelin e gjysmës së kapitalit më të lartë që nga krijimi i kooperativë.

**Procedura e themelimit:** Kooperativa themelohet në Kuvendin themelues **në të cilin miratohet** Statuti i saj apo përmes nënshkrimit të aktit të themelimit/Statutit dhe kontributit në kapitalin e përgjithshëm.

**Organet e Kooperativës**

- Kuvendi i përgjithshëm;
- Këshilli drejtues;
- Kryetari i Këshillit Drejtues;
- Drejtori i kooperativës, i cili nuk mund të jetë anëtar i kooperativës, por i punësuar me kontratë.

**Format e bashkimit të kooperativave:**

- Federata e Kooperativave të Bujqve të Kosovës – anëtarësimi vullnetar;
- Bashkësia e Kooperativave të Bujqve**-** mund të themelohet nga dy apo më shumë kooperativa.

**Kontrolluesi i jashtëm financiar** - Bëhet nga personat e autorizuar nga MEF që do të thotë se kontrolli financiar bëhet nga kontrolluesi i jashtëm.

**Ndarja e të ardhurave neto dhe humbjet** (neni 15, 16)

Ligji përcakton prioritet e ndarjes së të ardhurave neto (fitimit) dhe atë: 5% në fondin e rezervës së domosdoshme; 5% në fondin rezervë, për kompensimin e aksioneve të anëtarëve që tërhiqen nga kooperativa; fondin rezervë (Shumën e përcaktuar me Statut); pagesa e anëtarëve të kooperativës në proporcion me aktivitetet e tyre në

kooperativë dhe shumat e mbetura në llogarinë e tepricës dhe humbjeve të akumuluara, ose në fondet tjera që duhet të ruhen si rezervë.

Kur pasuria neto për shkak të humbjeve bie në më pak se gjysma e kapitalit më të lartë aksionar të pranuar që nga themelimi i kooperativës, Kuvendit i Përgjithshëm do të vendos se a do të likuidohet kooperativa, apo të mbahet. Nëse kooperativa mbahet, anëtarët do të kontribuojnë me shumën e nevojshme për arritjen e pasurisë neto të kooperativës në nivelin e lejuar.

**Likuidimi.** Neni 17 par. 4: "*Pasuria neto që mbetet pas pagimit të të gjithë kreditorëve dhe pagimin e kontributeve të anëtarëve nuk do t'u ndahet anëtarëve. Pasuria neto detyrimisht do të transferohet në një kooperativë tjetër ose bashkësi të kooperativave të bujqve, ose të një organizatë tjetër ligjore të kooperativave të bujqve.*"

**Regjistrimi i kooperativave ekzistuese në kohen e aprovimit të ligjit**

**Neni 23 par.1:** "Kooperativat ekzistuese bujqësore do të ri regjistrohen si Kooperativa të Bujqve sipas këtij ligji brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose do ta humbin statusin e kooperativës së Bujqve. (Është fshi "Dispozitat kalimtare" nga titulli i nenit me Ligjin Nr. 03/L-*004* për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazë).

Ndër mangësitë e ligjit mund të konsiderohen se:

Ligji nuk i përmban parimet themelore të kooperativave të përcaktuara me legjislacionin e BE-së për kooperativa.

Ligji parasheh vetëm kontrollin e jashtëm financiar por jo edhe kontrollin e brendshëm i cili do të kryhej nga ndonjë organ i zgjedhur apo i caktuar nga Kuvendi i Kooperativës (ku do të përfshiheshin anëtarë dhe punëtorët të kooperativës, dhe një person jashtë kooperative ) i cili, përveç kontrollit financiar do të bënte edhe kontrollin e ligjshmërisë së udhëheqjes së afarizmit të kooperativave dhe çështje tjera që caktohen me statut.
Me Ligj nuk specifikohet shuma e kontributit aksionar me rastin e themelimit të kooperativës, pagesa e anëtarësisë si formë e krijimit të kapitalit të kooperativës si dhe kush e cakton shumen e anëtarësisë.

Nuk është saktësuar qartë roli i themeluesit (aksionarit) dhe anëtarit si dhe zbatimi i parimit të barazisë në udhëheqjen e kooperativës përmes parimit "një anëtar, një votë".

Sa i përket funksionit dhe rolit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përveç hartimit të akteve nënligjore, ligji nuk përmban asnjë dispozitë për rolin e ministrisë, siç mund të jenë: rolit mbikëqyrës i MBPZHR-së për zbatimin e ligjit; ofrimit i këshillave përmes shërbimeve këshillimore, ofrimi i mbështetjes së bujqve

gjatë themelimit dhe viteve të para të punës së kooperativës etj. Gjithashtu nuk ka dispozita rreth zhvillimit të mekanizmave financiar për kooperativat bujqësore apo anëtarët e tyre (subvencione, kredi të buta, politika lehtësuese tatimore, etj.) Edhe pse titulli i nenit 20 të ligjit i referohet subvencioneve, teksti i nenit ka përmbajtja tjetër.

**Fragmentimi i tokave bujqësore** në Kosovë është mjaftë i shprehur, këtë argument mund ta vërejmë duke ju referuar madhësive të fermave në sipërfaqe (ha) dhe numrit të fermerëve të shprehur në përqindje (%) të cilat zyrtarisht janë të dokumentuara, duke ju referuar burimeve nga të dhënat e publikuara nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DAESB), si dhe burimet tjera, siç janë njësitë organizative të MBPZHR-së, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), del se në vitin 2020 gjithësej **sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore** ishte 420,210 ha me një % të shpërndarjes si në vijim: Livadhe dhe kullosa 52%, Tokë e punueshme-ara 43%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë), Kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2%, si dhe Plantacione të vreshtave 1%. Sa i përket **madhësisë së fermës** marrë parasysh sipërfaqen e tokës së punueshme – arave, 35% e sipërfaqes është në ferma me madhësi prej 5 deri në më pak se 10 ha, 21% e sipërfaqes në ferma prej 2 deri në më pak se 5 ha, 16% e sipërfaqes në ferma me madhësi prej 1 deri në më pak se 2 ha dhe pjesa tjetër e sipërfaqes është tek madhësitë e tjera. Sa i përket numrit të fermave, 91% e tyre kanë sipërfaqe me pak se 5 ha, ndërsa si sipërfaqe këto ferma mbulojnë 46% nga gjithsej sipërfaqja e tokës së punueshme – arave. Si pasoj e kësaj gjendje, në mungesë të një organizimi të mirëfilltë, interesimi i fermerëve për t'i punuar këto sipërfaqe bujqësore është i ulët, dhe si rezultat i saj vije deri te vazhdimi prodhimit ekstensiv.

**Kooperativat bujqësore** në Republikën e Kosovë, sipas të dhënave nga regjistri i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), figurojnë të jenë të regjistruara gjithësej gjashtëdhjetë e një (61) kooperativa të cilat merren me aktivitete të ndryshme bujqësore. Megjithatë, aktivitetet të cilat i realizojnë këto **"kooperativa bujqësore"** më shumë i ngjasojnë agrobizneseve të cilat realizojnë aktivitete tregtare të lidhura me bujqësinë. Një agrobiznes përfshinë të gjithë hapat e nevojshëm duke filluar furnizimi me inpute bujqësore, prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen produktit bujqësor në treg. Kjo industri është segment i rëndësishëm i ekonomisë e cila luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë në vendin tonë, duke e bërë të mundur lidhjen e drejtpërdrejtë të fermerit në tregje dhe industri të përpunimit. Megjithatë, organizimi i fermerëve përmes organizatave prodhuese dhe pastaj funksionimi i tyre përmes kooperativave bujqësore, duket si opsioni më i mirë i mundshëm për rrethanat ku gjendet bujqësia në Kosovë, sepse përmes organizimit të këtij sektori krijohen vende të reja pune, nga ku varen në mënyrë direkte ose indirekte numër i madh i të punësuarve.

**Anëtarët e kooperativave bujqësore** në vendin tonë, sipas të dhënave nuk ka ndonjë kooperativë e cila përbëhet prej shumë anëtarëve. Anëtar i një kooperative mund të bëhet çdo fermer, i cili paraprakisht do të duhej të paguante një shumë të caktuar të mjeteve për regjistrim, e cila është e bazuar në sipërfaqet e mbjella me kulturën bujqësore që ai posedon. Përderisa në vendet e zhvilluara kooperativat e vogla kanë filluar të bëhen anëtare e një grupi me të madh të kooperativa tjera, në vendin tonë mungesa e këtij organizimi është duke paraqitur pengesë serioze në zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme.

**Shërbimet Këshillimore** janë të organizuara në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe në nivel komunal, por të cilat më tepër kanë rol organizativ, ku përmes tyre do të duhej të shpërndaheshin të gjitha informacionet lidhur me rolin dhe rëndësinë e kooperativave bujqësore të cilat do të organizohen në vendin tonë. Mirëpo, për shkak të kapaciteteve të kufizuara në personel të shërbimit këshillimor dhe mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional, shpërndarja e informacioneve tek fermerët mund të jetë e kufizuar, mirëpo pas organizimit të kooperativave do të duhej të rritet numri i këshilltarëve, me qëllim mbështetjen e fermerëve anëtarë, përmes dhënies së këshillave profesionale në sektor të ndryshëm.

**Zhvillimi i institucioneve** është komponentë e rëndësishme e cila do t'i kontribuonte organizimit dhe funksionalizimit të kooperativave bujqësore të cilat do të kenë ndikim në plotësimin e nevojave për produkte bujqësore vendore. Në këtë aspekt, roli i institucioneve si: MBPZHR, AUV, IBK, Komunave, Doganës, Shoqatave, Kompanive prodhuese të farërave, dhe materialit fidanor, si dhe Fakulteteve të Bujqësisë, është i domosdoshëm dhe mbështetës rreth organizimit të kooperativave bujqësore në Kosovë. Në këtë rast, duhet theksuar se bashkëpunimi i institucioneve të lartpërmendura nuk është në nivelin e kënaqshëm.

## Prodhimtaria bimore

Gjendja e prodhimtarisë bujqësore në Kosovë, dhe ndikimi i saj në mirëqenien e fermerëve dhe ekonomi të vendit nuk është në nivelin e duhur, kjo rrjedhë si pasojë e disa faktorëve, siç janë:

- Mos shfrytëzimi racional i tokës së punueshme (arave) për prodhimtari bujqësore;
- Parcelizim i lartë i tokës së punueshme;
- Numri i lartë i fermave (91%) me madhësi më pak se pesë (5) hektarë.

Bazuar në këtë gjendje, si mundësi e vetme e cila mund të ndryshoj këtë situatë në interes të mirëqenies së fermerëve, por edhe në ekonomi të vendit, është organizimi i fermerëve përmes kooperativave bujqësore. Gjendja për sipërfaqet e kultivuara dhe prodhimin bujqësor për disa kultura bujqësore, të cilat llogariten si kultura strategjike për vendin tonë, është paraqitur në vazhdim:

**Drithërat**

Me drithëra në vitin 2021 në Kosovë janë kultivuar 124,477 ha, apo 237 ha më pak krahasuar me vitin 2020. Tek sipërfaqet me drithëra dominon kultura e grurit me 64.2% apo 79,970 ha të gjithsej sipërfaqes së kultivuar me drithëra. Trendet e kultivimit me kulturën e grurit nuk kanë ndryshime të rëndësishme për sipërfaqe. Me farë cilësore dhe të certifikuar janë kultivuar rreth 48,000 ha, ndërsa në sipërfaqen tjetër është përdor farë merkantile. Kultura e misrit në vitin 2021, kishte rritje në sipërfaqe për 0.1% krahasuar me vitin 2020 apo 39,710 ha, po ashtu edhe drithërat tjera kishin rritje të sipërfaqes kultivuese siç shihet në tabelën vijuese. Kultivimi i misrit kryesisht realizohet nga fara hibride (F1) e cila tërësisht vije nga importi, ndërsa disa dhjetëra hektarë mund të jenë kultivuar me farëra autoktone. Ndërsa, drithërat tjera kryesisht kultivohen me farë të importuar dhe në disa raste siç është kultura e elbit paraprakisht sipërfaqet kontraktohen dhe kërkuesit e prodhimit të elbit sigurojnë dhe farën.

**Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2017-2021**

| **Kultura** | **2017** | **2018** | **2019** | **2020** | **2021** | **Ndryshimi 2021/2020 në %** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Sipërfaqja** | | | **ha** | | | |
| **Drithëra** | ***120,746*** | ***123,869*** | ***124,199*** | ***124,714*** | ***124,477*** | **-0.2** |
| Grurë | 80,519 | 81,123 | 80,273 | 80,473 | 79,970 | *-0.6* |
| Misër | 35,951 | 38,453 | 39,441 | 39,684 | 39,710 | *0.1* |
| Elb | 1,605 | 1,948 | 1,954 | 1,982 | 2,060 | *3.9* |
| Thekër | 318 | 434 | 420 | 425 | 555 | *30.7* |
| Tërshërë | 2,320 | 1,797 | 1,975 | 2,009 | 2,030 | *1.1* |
| Drithëra të tjera kokërr | 33 | 113 | 136 | 141 | 153 | *8.4* |
| **Prodhimi** | | | **t** | | | |
| **Drithëra** | ***477,880*** | ***441,757*** | ***459,404*** | ***529,112*** | ***504,371*** | **-4.7** |
| Grurë | 320,136 | 280,616 | 284,999 | 341,818 | 322,018 | *-5.8* |
| Misër | 147,200 | 151,921 | 163,930 | 175,180 | 170,393 | *-2.7* |
| Elb | 4,687 | 5,124 | 5,159 | 5,764 | 5,610 | *-2.7* |
| Thekër | 866 | 1,049 | 1,010 | 1,153 | 1,409 | *22.2* |
| Tërshërë | 4,862 | 2,751 | 3,954 | 4,769 | 4,500 | *-5.7* |
| Drithëra të tjera kokërr | 129 | 296 | 352 | 427 | 441 | *3.3* |
| **Rendimenti** | | | **t/ha** | | | |
| Grurë | *3.98* | *3.46* | *3.55* | *4.25* | *4.03* | *-5.2* |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Misër | *4.09* | *3.95* | *4.16* | *4.41* | *4.29* | *-2.8* |
| Elb | *2.92* | *2.63* | *2.64* | *2.91* | *2.72* | *-6.3* |
| Thekër | *2.72* | *2.41* | *2.41* | *2.71* | *2.54* | *-6.5* |
| Tërshërë | *2.10* | *1.53* | *2.00* | *2.37* | *2.22* | *-6.6* |
| Drithëra të tjera kokërr | *3.87* | *2.62* | *2.59* | *3.03* | *2.89* | *-4.7* |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Prodhimi i përgjithshëm i grurit vendor ishte 322,018 tonë, i cili mbulon 69.6% të nevojave vendore. Pjesa më e madhe e grurit është përdorur për konsum njerëzor dhe pjesa tjetër është shitur dhe përdorur për ushqim të kafshëve. Vlera e prodhimit vendor të grurit ishte 64.4 mil. €, ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, dhe vlera e tij është rritur për shkak të ngritjes së çmimeve në tregun ndërkombëtar por edhe asaj se sasia e importuar e grurit dhe produkteve të grurit është rritur në vitin 2021. Në vitin 2021, konsumi mesatar për kokë banori për grurë, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje gruri e që përmes koeficienteve të konvertimit janë konvertuar në grurë, ishte 207 kg. Me misër në vitin 2021 janë kultivar 39,684 ha apo 31.9% e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me drithëra. Me sasinë e prodhuar prej 170,393 tonë, Kosova mbulon 78% të nevojave të saj, ku pjesa më e madhe është përdorur si ushqim i kafshëve. Për të përmbushur nevojat e përgjithshme misër edhe importohet, dhe bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 15.6 mil. €, e që u thellua për shkak të çmimeve më të larta në vitin 2021, përkundër faktit se sasia e importuar ishte më e ulët krahasuar me vitin 2020. Konsumi mesatar për kokë banori për misër, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje misri në vitin 2021 ishte 44 kg.

**Perimet**

Kulturat perimore kanë specifika të veçanta krahasuar me drithërat që kultivohen në Kosovë, mjediset e kultivimit të tyre dhe mënyrat e shumimit. Farërat e perimeve, me përjashtim të patates, nuk i nënshtrohen testimeve fushore por vetëm atyre fitosanitare dhe analitike në laborator.

Sipërfaqet me perime në Kosovë të kultivuara në fushë të hapur, në serra dhe në kopshte llogariten të jenë gjithsej 19,399 ha gjatë vitit 2021. Kulturat të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë: patatja (3,854 ha), speci (3,146 ha), kungulli (2,612 ha), fasulja (2,914 ha), qepa (1,369 ha), shalqiri (1,309 ha), lakra (923 ha), kungulli i misirit (918 ha), domatja (800 ha), pjepri (321 ha), trangulli (305 ha) dhe kulturat tjera perimore të cilat ndajnë një sipërfaqe më të vogël krahasuar me kulturat e prezantuara më lartë.

Nëse analizohet ndryshimi mes vitit 2020 dhe 2021, në sipërfaqet me kultura perimore vërehet se pothuajse të gjitha kulturat kanë shënuar rritje të lehtë në sipërfaqe, përpos

trangullit, domates dhe hudhrës të cilat kanë shënuar zvogëlim të sipërfaqeve. Shikuar në aspektin e përgjithshëm totali i përgjithshëm i sipërfaqeve me perime është rritur për 0.8%, krahasuar me vitin 2020.

**Sipërfaqja me perime, 2017 – 2021**

| Kultura | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Sipërfaqja | ha | | | | | |
| Perime | 19,643 | 17,886 | 18,911 | 19,243 | 19,399 | 0.8 |
| Patate | 4,290 | 3,606 | 3,688 | 3,771 | 3,854 | 2.2 |
| Domate | 862 | 757 | 794 | 815 | 800 | -1.8 |
| Patëllxhan i zi | 8 | 6 | 8 | 7 | 8 | 11.7 |
| Spec | 3,035 | 3,038 | 3,108 | 3,134 | 3,146 | 0.4 |
| Kungull | 2,270 | 2,255 | 2,502 | 2,577 | 2,612 | 1.4 |
| Kungull misiri | 684 | 810 | 898 | 913 | 918 | 0.5 |
| Trangull | 305 | 273 | 304 | 313 | 305 | -2.7 |
| Shalqi | 1,201 | 1,182 | 1,216 | 1,303 | 1,309 | 0.4 |
| Pjepër | 388 | 298 | 313 | 318 | 321 | 0.9 |
| Lakër | 917 | 832 | 906 | 918 | 923 | 0.5 |
| Lulelakër | 47 | 46 | 53 | 50 | 52 | 3.8 |
| Spinaq | 161 | 160 | 197 | 150 | 154 | 2.8 |
| Sallatë | 92 | 78 | 88 | 79 | 82 | 3.7 |
| Panxhar i kuq | - | 9 | 9 | 7 | 7 | 2.1 |
| Rrepkë (rillkë) | - | 5 | 5 | 5 | 5 | 2.7 |
| Majdanoz | 10 | 11 | 11 | 11 | 12 | 8.9 |
| Presh (purri) | 73 | 72 | 75 | 76 | 78 | 2.7 |
| Qepë | 1,465 | 1,185 | 1,354 | 1,367 | 1,369 | 0.1 |
| Hudhër | 138 | 146 | 234 | 264 | 263 | -0.6 |
| Fasule | 3,406 | 2,845 | 2,888 | 2,904 | 2,914 | 0.3 |
| Bizele | 99 | 55 | 67 | 68 | 69 | 1.6 |
| Bishtajoret tjera | 54 | 69 | 42 | 43 | 46 | 5.4 |
| Karota | 107 | 112 | 121 | 126 | 129 | 2.6 |
| Perime tjera | 32 | 37 | 29 | 22 | 23 | 5.3 |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Sa i përket prodhimit për vitin 2021, prodhimi i perimeve vlerësohet të jetë 282,734 tonë për totalin e sipërfaqes prej 19,399 ha, që krahasuar me vitin 2020, vërehet

zvogëlim i prodhimit për 2.7%. Referuar të dhënave të prodhimit të kulturave perimore për vitin 2021, mund të themi se kulturat si patatja, kungulli, kungulli i misirit, speci, lakra dhe shalqiri kanë prodhim më të lartë (mbi 20,000 tonë), pasuar nga kulturat tjera si domatja, qepa, trangulli, fasulja, pjepri, etj. që shënojnë sasinë e prodhimit nën 20,000 tonë.

**Prodhimi i perimeve, 2017 – 2021**

| Kultura | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi | | | t | | | |
| Perime | 358,394 | 265,420 | 300,559 | 290,555 | 282,734 | -2.7 |
| Patate | 118,250 | 68,790 | 73,816 | 74,508 | 73,984 | -0.7 |
| Domate | 24,698 | 22,639 | 22,466 | 20,242 | 19,163 | -5.3 |
| Patëllxhan i zi | 204 | 107 | 155 | 137 | 144 | 5.0 |
| Spec | 62,934 | 49,907 | 59,404 | 53,889 | 52,381 | -2.8 |
| Kungull | 25,564 | 20,208 | 23,050 | 22,535 | 22,326 | -0.9 |
| Kungull misiri | 16,220 | 18,376 | 21,570 | 21,712 | 20,896 | -3.8 |
| Trangull | 10,204 | 7,009 | 9,173 | 9,055 | 8,480 | -6.4 |
| Shalqi | 28,740 | 22,918 | 25,209 | 26,324 | 25,971 | -1.3 |
| Pjepër | 6,113 | 4,141 | 4,409 | 4,335 | 4,103 | -5.3 |
| Lakër | 25,184 | 21,997 | 25,259 | 24,850 | 24,123 | -2.9 |
| Lulelakër | 911 | 725 | 1,004 | 905 | 885 | -2.2 |
| Spinaq | 1,546 | 1,348 | 2,053 | 1,452 | 1,408 | -3.1 |
| Sallatë | 1,186 | 683 | 835 | 677 | 635 | -6.2 |
| Panxhar i kuq | - | 73 | 80 | 56 | 51 | -8.8 |
| Rrepkë (rillkë) | - | 39 | 52 | 49 | 45 | -7.1 |
| Majdanoz | 143 | 87 | 125 | 123 | 130 | 5.7 |
| Presh (purri) | 1,671 | 1,303 | 1,440 | 1,425 | 1,398 | -1.9 |
| Qepë | 22,436 | 16,317 | 19,879 | 18,859 | 17,792 | -5.7 |
| Hudhër | 971 | 873 | 1,628 | 1,588 | 1,471 | -7.4 |
| Fasule | 8,687 | 5,688 | 6,713 | 5,708 | 5,349 | -6.3 |
| Bizele | 348 | 146 | 169 | 152 | 138 | -9.5 |
| Bishtajoret tjera | 219 | 254 | 139 | 126 | 116 | -8.3 |
| Karota | 1,838 | 1,493 | 1,703 | 1,694 | 1,585 | -6.4 |
| Perime tjera | 326 | 298 | 227 | 155 | 162 | 4.2 |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Sa i përket rendimentit të perimeve për vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak në të gjitha kulturat vërehet zvogëlim i rendimentit, e njëjta situatë paraqitet edhe tek prodhimi ku krahasuar me vitin 2020 niveli i prodhimit është më i ulët. Këto ndryshime në rendiment kanë ardhur si pasojë ndryshimit të kushteve klimatike (thatësi dhe breshër).

**Tabela 5: Rendimenti i perimeve, 2017 – 2021**

| Kultura | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rendimenti | | t /ha | | | | |
| Patate | 27.56 | 19.08 | 20.01 | 19.76 | 19.20 | -2.8 |
| Domate | 28.67 | 29.90 | 28.29 | 24.84 | 23.95 | -3.5 |
| Patëllxhan i zi | 26.32 | 16.90 | 19.19 | 18.44 | 17.34 | -6.0 |
| Spec | 20.74 | 16.43 | 19.11 | 17.19 | 16.65 | -3.2 |
| Kungull | 11.26 | 8.96 | 9.21 | 8.74 | 8.55 | -2.3 |
| Kungull misiri | 23.71 | 22.70 | 24.01 | 23.77 | 22.76 | -4.3 |
| Trangull | 33.50 | 25.66 | 30.20 | 28.91 | 27.82 | -3.8 |
| Shalqi | 23.93 | 19.38 | 20.73 | 20.20 | 19.84 | -1.8 |
| Pjepër | 15.77 | 13.92 | 14.08 | 13.64 | 12.80 | -6.2 |
| Lakër | 27.46 | 26.44 | 27.88 | 27.07 | 26.13 | -3.4 |
| Lulelakër | 19.19 | 15.93 | 18.84 | 18.00 | 16.96 | -5.8 |
| Spinaq | 9.59 | 8.44 | 10.41 | 9.71 | 9.15 | -5.7 |
| Sallatë | 12.82 | 8.79 | 9.47 | 8.58 | 7.76 | -9.6 |
| Panxhar i kuq | - | 8.43 | 8.99 | 7.97 | 7.13 | -10.6 |
| Rrepkë (rillkë) | - | 8.32 | 10.52 | 10.07 | 9.11 | -9.5 |
| Majdanoz | 14.21 | 8.15 | 11.20 | 10.95 | 10.63 | -2.9 |
| Presh (purri) | 23.05 | 18.00 | 19.29 | 18.82 | 17.97 | -4.5 |
| Qepë | 15.32 | 13.77 | 14.68 | 13.80 | 13.00 | -5.8 |
| Hudhër | 7.04 | 5.97 | 6.97 | 6.00 | 5.59 | -6.9 |
| Fasule | 2.55 | 2.00 | 2.32 | 1.97 | 1.84 | -6.6 |
| Bizele | 3.52 | 2.64 | 2.52 | 2.23 | 1.99 | -11.0 |
| Bishtajoret tjera | 4.02 | 3.67 | 3.27 | 2.91 | 2.53 | -13.0 |
| Karota | 17.21 | 13.35 | 14.09 | 13.46 | 12.28 | -8.8 |
| Perime tjera | 10.23 | 8.12 | 7.79 | 7.05 | 6.98 | -1.1 |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Në gjithsej sipërfaqen e mbjellë me perime prej 19,399 ha për vitin 2021, sipërfaqja me domate merr pjesë me 4.1%. Sipërfaqja dhe prodhimi i domates kanë shënuar rënie në vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak për 1.8%, ndërsa prodhimi 5.3%, dhe kështu mbulohen gjithsej 50.8% të nevojave për konsum. Pjesa tjetër mbulohet nga importi me 18,685 tonë, ndërsa eksporti shënon 136 tonë. Vlera e prodhimit ishte 9.6 mil. €, ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ.

**Pemët**

Sipërfaqja me pemë në Kosovë për vitin 2021 shënon 10,382 ha, krahasuar me vitin 2020 ku sipërfaqja ishte 10,265 ha ku vërehet rritje e vogël për 1.1%. Ndër kulturat të cilat kryesojnë me sipërfaqe janë: molla 3,083 ha, kumbulla 2,210 ha, mjedra 1,665 ha, arra 1,352 ha, pasuar nga kultura tjera si dardha, lajthia, dredhëza, vishnja, etj.

Sa i përket prodhimit të pemëve që shënon 67,533 tonë për vitin 2021, kjo sasi paraqitet për 6.5% më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Shumica e kulturave krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar ulje.

Nga kulturat të cilat gjatë vitit 2021 kanë shënuar sasi të prodhimit më të lartë, vlenë të ceken molla (37,381 tonë), kumbulla (11,247 tonë), mjedra (5,840 tonë), dardha (4,953 tonë), arra (2,108 tonë), pasuar nga kultura tjera me sasi më të ulët prodhimi.

**Sipërfaqja dhe prodhimi i pemëve, 2017 – 2021**

| Kultura | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Sipërfaqja** | | | **ha** | | | |
| **Pemët** | **6,422** | **7,922** | **9,479** | **10,265** | **10,382** | **1.1** |
| Molla | 2,155 | 2,556 | 3,006 | 3,068 | 3,083 | 0.5 |
| Dardha | 456 | 479 | 610 | 614 | 618 | 0.7 |
| Ftoni | 39 | 64 | 90 | 91 | 93 | 2.6 |
| Mushmolla | 41 | 50 | 51 | 51 | 53 | 4.0 |
| Kumbulla | 1,524 | 1,821 | 2,096 | 2,201 | 2,210 | 0.4 |
| Kajsia | 11 | 14 | 22 | 22 | 24 | 5.9 |
| Pjeshka | 26 | 34 | 47 | 48 | 51 | 5.5 |
| Qershia | 78 | 82 | 107 | 108 | 110 | 2.0 |
| Vishnja | 149 | 167 | 232 | 233 | 240 | 3.0 |
| Arra | 340 | 608 | 886 | 1,295 | 1,352 | 4.4 |
| Lajthia | 95 | 119 | 252 | 390 | 391 | 0.3 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dredhëza | 175 | 234 | 235 | 236 | 238 | 1.0 |
| Mjedra | 1,231 | 1,537 | 1,637 | 1,661 | 1,665 | 0.3 |
| Manaferra | 21 | 24 | 30 | 31 | 32 | 3.9 |
| Boronica | 33 | 37 | 57 | 86 | 93 | 8.3 |
| Aronia | - | - | 88 | 98 | 98 | 0.4 |
| Pemë tjera | 48 | 94 | 31 | 32 | 30 | -6.2 |
| **Prodhimi** | | | **t** | | | **%** |
| **Pemët** | **34,207** | **53,606** | **67,294** | **72,265** | **67,533** | **-6.5** |
| Molla | 13,159 | 26,093 | 33,835 | 38,049 | 37,381 | -1.8 |
| Dardha | 2,083 | 3,500 | 5,110 | 5,586 | 4,953 | -11.3 |
| Ftoni | 255 | 925 | 1,283 | 1,264 | 1,266 | 0.2 |
| Mushmolla | 129 | 179 | 222 | 219 | 213 | -2.6 |
| Kumbulla | 7,393 | 10,643 | 12,745 | 13,147 | 11,247 | -14.5 |
| Kajsia | 59 | 38 | 100 | 94 | 94 | 0.2 |
| Pjeshka | 130 | 199 | 330 | 288 | 262 | -9.1 |
| Qershia | 298 | 410 | 586 | 538 | 485 | -9.9 |
| Vishnja | 599 | 427 | 777 | 740 | 705 | -4.7 |
| Arra | 405 | 761 | 2,028 | 2,591 | 2,108 | -18.6 |
| Lajthia | 17 | 29 | 80 | 116 | 101 | -12.7 |
| Dredhëza | 1,328 | 1,316 | 1,677 | 1,487 | 1,439 | -3.2 |
| Mjedra | 7,747 | 8,267 | 7,206 | 6,659 | 5,840 | -13.2 |
| Manaferra | 181 | 246 | 239 | 233 | 223 | -4.6 |
| Boronica | 271 | 306 | 310 | 464 | 469 | 1.0 |
| Aronia | - | - | 666 | 692 | 656 | -5.2 |
| Pemë tjera | 153 | 265 | 101 | 97 | 90 | -7.2 |

Burimi:  ASK – Anketa e ekonomive bujqësore (’17,’18,’19,’20,’21)

Sa i përket rendimentit të pemëve për vitin 2021, kulturat të cilat kishin rendiment më të lartë gjatë këtij viti janë: ftoi, molla, dardha, manaferra, aronia, etj. Ndërsa krahasuar me vitin paraprak në të gjitha kulturat vërehet zvogëlim i rendimentit, këto ndryshime në rendiment kanë ardhur si pasojë e ndryshimit të kushteve klimatike si thatësia dhe breshëri, sikurse edhe tek perimet.

**Rendimenti i pemëve, 2017 - 2021**

| Kultura | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rendimenti** | | | t/ha | | | |
| Molla | 6.11 | 10.21 | 11.25 | 12.40 | 12.12 | -2.2 |
| Dardha | 4.56 | 7.31 | 8.38 | 9.10 | 8.01 | -12.0 |
| Ftoni | 6.51 | 14.47 | 14.24 | 13.94 | 13.61 | -2.4 |
| Mushmolla | 3.14 | 3.60 | 4.36 | 4.27 | 4.00 | -6.3 |
| Kumbulla | 4.85 | 5.84 | 6.08 | 5.97 | 5.09 | -14.8 |
| Kajsia | 5.13 | 2.79 | 4.56 | 4.23 | 4.00 | -5.3 |
| Pjeshka | 4.98 | 5.78 | 6.95 | 6.00 | 5.17 | -13.8 |
| Qershia | 3.83 | 4.98 | 5.46 | 4.98 | 4.40 | -11.6 |
| Vishnja | 4.01 | 2.55 | 3.34 | 3.17 | 2.94 | -7.5 |
| Arra | 1.19 | 1.25 | 2.29 | 2.00 | 1.56 | -22.0 |
| Lajthia | 0.18 | 0.25 | 0.32 | 0.30 | 0.26 | -12.9 |
| Dredhëza | 7.58 | 5.62 | 7.14 | 6.30 | 6.04 | -4.1 |
| Mjedra | 6.30 | 5.38 | 4.40 | 4.01 | 3.51 | -12.5 |
| Manaferra | 8.73 | 10.16 | 7.88 | 7.53 | 6.92 | -8.1 |
| Boronica | 8.21 | 8.20 | 5.48 | 5.40 | 5.03 | -6.7 |
| Aronia | - | - | 7.55 | 7.08 | 6.69 | -5.5 |
| Pemë tjera | 3.21 | 2.81 | 3.24 | 3.03 | 3.00 | -1.0 |

Burimi:  ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Nga sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me pemë, kultura e mollës merr pjesë me 29.7%. Sipërfaqja e mollës ka shënuar rritje të lehtë gjatë vitit 2021 për 0.5%, ndërsa prodhimi është më i ulët për 1.8% krahasuar me vitin 2020. Me këtë prodhim arrihet të mbulohen 77.6% të nevojave për konsum, kurse pjesa tjetër mbulohet nga importi me 10,938 tonë, ndërsa eksporti shënon 136 tonë. Vlera e prodhimit shënon 14.8 mil. € ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ.

**Vreshtat**

Gjatë vitit 2021, sipërfaqet me vreshta janë rritur vetëm për 1% (34 ha). Sipërfaqet me rrush tryeze janë rritë për 2.9%, ndërsa ato me rrush për verë për 0.3%. Sa i përket prodhimit ka pasur rritje të ulët me vetëm 0.7%, ndërsa rendimenti ka shënuar ulje me 0.2% krahasuar me vitin 2020. Gjithë këto ndryshime kanë ardhur si rezultat i sëmundjeve dhe breshrit që ka karakterizuar vitin 2021. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna për sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e rrushit të tryezës dhe të verës për periudhën '17-'21.

**Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i rrushit, 2017-2021**

| Kultura | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Sipërfaqja** | **ha** | | | | | |
| **Vreshta** | **3,199** | **3,272** | **3,367** | **3,437** | **3,471** | **1.0** |
| Rrush tryeze | 799 | 816 | 878 | 911 | 938 | 2.9 |
| Rrush për verë | 2,400 | 2,455 | 2,489 | 2,526 | 2,533 | 0.3 |
| **Prodhimi** | **t** | | | | | |
| **Vreshta** | **15,364** | **27,322** | **19,318** | **26,330** | **26,527** | **0.7** |
| Rrush tryeze | 3,187 | 4,998 | 4,546 | 6,281 | 7,435 | 18.4 |
| Rrush për verë | 12,177 | 22,324 | 14,772 | 20,049 | 19,091 | -4.8 |
| **Rendimenti** | **t/ha** | | | | | |
| **Vreshta** | **4.8** | **8.4** | **5.7** | **7.7** | **7.6** | **-0.2** |
| Rrush tryeze | 4.0 | 6.1 | 5.2 | 6.9 | 7.9 | 15.0 |
| Rrush për verë | 5.1 | 9.1 | 5.9 | 7.9 | 7.5 | -5.0 |

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

Në vijim janë paraqitur të dhënat lidhur me bilancin e furnizimit për rrushin e tryezës. Në vitin 2021, shkalla e vetëmjaftueshmërisë së rrushit të tryezës shënon 72% krahasuar me vitin paraprak që ishte 71%. Pjesa tjetër u mbulua nga importi me 2,970 tonë, i cili ishte 12% më i lartë se në vitin 2020. Eksporti i rrushit të tryezës në vitin 2021 pësoi rënie të dukshme (68%), nga 78 në 25 tonë. Vlera e prodhimit të kësaj kulture në vitin 2021 ishte 3.9 mil. €, që është e përafërt me vitin 2020. Bilanci tregtar në vitin 2021 vazhdon të jetë negativ me vlerë prej 1.4 mil €.

**Verërat**

Prodhimi i verës në vitin 2021 ka shënuar ulje për 17% krahasuar me vitin 2020. Nga 9,429 mijë litra sa ishin prodhuar në vitin 2020, në vitin 2021 sasia u zvogëlua në 7,785. Vera e bardhë ka shënuar zvogëlim për 7%, vera e kuqe për 30%, ndërsa vera roze ka shënuar rritje për 14%, krahasuar me vitin paraprak.

**Prodhimi i verës 2017-2021, '000 litra**

| Prodhimi | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Ndryshimi 2021/2020 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Verë e bardhë | 2,024 | 6,234 | 3,380 | 5,100 | 4,744 | -7 |
| Verë e kuqe | 1,455 | 5,441 | 2,325 | 4,295 | 3,001 | -30 |
| Verë Roze | 1,826 | 69 | 49 | 35 | 40 | 14 |
| **Gjithsej verë** | **5,305** | **11,744** | **5,754** | **9,429** | **7,785** | **-17** |

Burimi: Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZHR

**Madhësia e fermës**

Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2020, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,210 ha, nga kjo sipërfaqe gjithsej toka e punueshme-ara ishin 186,389 ha apo 44%, ku janë të përfshira 103,723 ekonomi bujqësore.

**Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2020**

| Madhësia e fermës | Sipërfaqja (ha) | Pjesëmarrja (%) | Nr. i Ekonomive Bujqësore | Pjesëmarrja (%) |
|---|---|---|---|---|
| 0 dhe më pak se 0.5 | 6,453 | 3.5 | 31,290 | 30.2 |
| 0.5 deri më pak se 1 | 11,999 | 6.4 | 17,560 | 16.9 |
| 1 deri më pak se 2 | 29,005 | 15.6 | 22,560 | 21.8 |
| 2 deri më pak se 5 | 38,665 | 20.7 | 23,383 | 22.5 |
| 5 deri më pak se 10 | 64,819 | 34.8 | 7,063 | 6.8 |
| 10 deri më pak se 20 | 16,800 | 9.0 | 1,429 | 1.4 |
| 20 deri më pak se 30 | 5,255 | 2.8 | 240 | 0.2 |
| 30 e më shumë | 13,393 | 7.2 | 198 | 0.2 |
| Gjithsej* | **186,389** | **100%** | **103,723** | **100 %** |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

*Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore

Në Kosovë madhësia e fermës prej 5 deri më pak se 10 ha, përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme - arave, pasuar nga madhësia e fermave prej 2 deri më pak se 5 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%), dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.

**Madhësia e fermës sipas sipërfaqes 2020, në %**




Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

Numri më i madh i ekonomive bujqësore në Kosovë posedojnë kryesisht fermat që për nga madhësia dominojnë fermat me madhësi të vogël të sipërfaqes. Kështu që fermat me madhësi nga 0 deri më pak se 0.5 ha posedojnë 30% të ekonomive bujqësore, pasuar nga madhësia 2 deri më pak se 5 ha (23%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (22%), dhe grupet e tjera që kanë pjesëmarrje më të vogël. Numri më i vogël i ekonomive bujqësore apo 0.2% kishin ferma me madhësi 20 deri më pak se 30 ha, dhe 30 e më shumë ha paraqiten vetëm 0.2% e ekonomive bujqësore.

**Numri i ekonomive bujqësore sipas madhësisë së fermës 2020, (%)**




Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

Tabela e mëposhtme përmban një analizë sintetike të mundësive dhe kërcënimeve të kooperativave bujqësore në Kosovë.

| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| --- | --- |
| - Fragmentim i lartë i fermerëve vendas.<br>- Nuk ka negociata të përbashkëta kur i shesin një përpunuesi ose qendre grumbullimi (çmimi, koha e dorëzimit dhe kërkesat e cilësisë).<br>- Ekziston një kapital i madh kulturor dhe social (ruani identitetin lokal dhe njohuritë/përvojën tradicionale) në të njëjtën kohë ekziston një potencial i madh i pashfrytëzuar.<br>- Përpunuesit në Kosovë e kanë të vështirë të blejnë lëndë të parë qoftë në sasinë apo cilësinë e duhur për fabrikën e tyre.<br>- Po përcaktohen kuadri ligjor, synimet strategjike për zhvillimin e kooperativave dhe zbatimin e ZKM-së, duke ofruar modelin e organizatave të prodhuesve dhe treguesit gjeografikë.<br>- Ekziston një potencial i madh për zgjerimin e bujqësisë organike.<br>- Kushte të mira agro-ekologjike për prodhimin e ushqimit dhe përvojë e pasur tradicionale.<br>- Tregu ndërkombëtar i produkteve agroushqimore është në evolucion dhe ndryshime të vazhdueshme, duke ofruar mundësi biznesi.<br>- Vëmendja e donatorëve për bujqësinë, përfshirë kooperativat bujqësore.<br>- Parimet nga ferma në pirun stimulojnë nismat agro-mjedisore nga fermerët dhe kooperativat bujqësore, të cilët mund të jenë më efikas në afirmimin dhe zbatimin e tij.. | - Pjesë e madhe e ekonomisë informale në bujqësinë vendase.<br>- Konkurrencë e lartë në tregjet agroushqimore.<br>- Mungesa e fondeve për funksionimin e qëndrueshëm të kooperativave bujqësore.<br>- Anëtarësimi në BE përcakton miratimin e më shumë standardeve të cilësisë nga fermerët dhe blerësit e mëdhenj kërkojnë furnizime të standardizuara dhe cilësore që kooperativat bujqësore nuk mund t'i ofrojnë.<br>- Niveli i edukimit specifik për kooperativat bujqësore është i ulët.<br>- Zbatimi i standardeve të tregut nuk ka filluar ende.<br>- Mungesa e fushatave të komunikimit dhe ndërgjegjësimit për krijimin e kushteve të favorshme për rritjen e kooperativave bujqësore.<br>- Hendeku i njohurive në nivel të institucioneve kompetente për funksionimin e kooperativave bujqësore.<br>- Në të gjitha nivelet mungon një sistem arsimor specifik për kooperativat.<br>- Përhapje e kufizuar e qasjes LEADER dhe GLV-ve.<br>- Politikat mbështetëse në nivel lokal (grupe, tregues gjeografikë) mungojnë.<br>- Rrezik i lartë në bujqësi - mekanizmat e sigurimit nuk janë efektiv.<br>- Mungesa e bashkëpunimit dhe partneritetit në zinxhirët agroushqimor.<br>- Legjislacioni anësor jo i homogjenizuar mund të ndikojë në zhvillimin e kooperativave bujqësore. |

| | |
|---|---|
| | - Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike është i disponueshëm për të mbështetur rritjen e kooperativave bujqësore vendase, por i mungon kapaciteti i nevojshëm.<br>- Shpopullimi i përgjithshëm dhe veçanërisht i zonave rurale. |

**Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore**

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare | Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim | Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve) |
|---|---|---|---|
| Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028 | https://img1.ësimg.com/blobby/go/03cefef5-701c-45ac-b2d7-bc72ecee7da2/doënloads/STRATEGJIA%202022-2028%20ALB.pdf?ver=1696945063378 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | -Hartimi i politikave për Bujqësi dhe Zhvillim Rural<br>-Hartimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural<br>-Përgatitja e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural<br>-Monitorimi i zbatimit të dokumentit strategjik të miratuar dhe ndërmarrjen e masave për zbatimin e politikave të përcaktuara<br>Hartimi i Raportit të performancës për zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të veprimit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | -Hartimi i legjislacioni (ligjeve dhe akteve nënligjore nga lëmi bujqësisë)<br><br>-Mbikëqyrja e zbatimin të legjislacionit |
| Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027 | https://azhb-rks.net/repository/docs/2022_07_19_095835_Programi__per_zhvillim_rural_2022.pdf | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | Përcakton objektivat e përgjithshme dhe specifike në qëndrueshmërinë ekonomike dhe aftësitë konkurruese të prodhuesve dhe përpunuesve të prodhimeve bujqësore si dhe përpunimi i tyre drejt zbatimit të standardeve vendore në harmoni me standardet e BE-së. |
| Plani Strategjik i Sistemit Këshillimor të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027 | https://ëëë.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Planin_Strategjik_te_Sistemit_Keshilles_te_Kosoves_per_Bujqesi_dhe_Zhvillim_rural_20232027.pdf | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br><br>Departamenti i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | Organizimi i shërbimeve këshillimore- Niveli qendror dhe lokal<br><br>Certifikimi i këshilltarëve<br><br>Identifikimi i qendrave trajnuese<br><br>Përcjellja e zbatimit të planit të veprimit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji nr. 2003/9, për kooperativat e bujqve;<br>Ligji nr.08/l-095 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2003/9 për kooperativat e bujqëve; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2472 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | -Specifikimi i formën dhe përmbajtjes së statutit që do të shfrytëzohet nga kooperativat<br><br>- Nxjerrja e Udhëzimeve Administrative për zbatimin e ligjit për kooperativat e bujqëve. |
| Ligji nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71733 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)<br><br>Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) | - MBPZHR bënë hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural.<br><br>- AZHB është përgjegjëse për zbatimin e masave për bujqësi dhe zhvillim rural |
| Ligji nr. 04/l-074 për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2805 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br><br>Departamenti i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | Nxjerr e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit.<br><br>Harton dhe zbaton plan programin vjetor të trajnimeve të këshilltarëve<br><br>Lëshon e licencat për ushtrimin e veprimtarisë të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Komisionin për mbikëqyrjen dhe koordinimin e punëve të shërbimeve këshilluese | shërbimeve këshilluese<br><br>Mbikëqyrë zbatimin e ligjit |
| Ligji Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2450 | | përcakton shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme si dhe Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij. |
| Ligji nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2429 | -Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) | - ARBK bën regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2858 | -Njësitë e vetëqeverisjes lokale/Komunat | - Hartojnë dhe e publikojnë listën e pronave komunale, përfshi tokën bujqësore, për dhënien në shfrytëzim si dhe zhvillojnë procedurat e përcaktuara me ligj.<br><br>-Zbatojnë procedurën e përcaktuar me ligj për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga AKP dhe këmbimi e pronës komunale. |
| Udhëzimi Administrativ nr. 06/2004 për përmbajtjen e statutit dhe kushtet e regjistrimit të kooperativave të bujqve | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7219 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br><br>Kuvendi i Kooperativës | Hartimi i formularit për regjistrim të kooperativave bujqësore, pagesën e taksave, dhe mundësive teknike të regjistrimit.<br><br>Aprovimi i Statutit të Kooperativës |
| Udhëzimi Administrativ nr. 10/2004 për Federatën e kooperativave të bujqve të Kosovës | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7228 | Federata e Kooperativave të Bujqve të Kosovës | -Zhvillimi dhe përhapja e konceptit dhe praktikës kooperativiste.<br><br>-Koordinimi efektiv i aktiviteteve ekonomike dhe afariste të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | kooperativave të bujqve në Kosovë dhe jashtë.<br><br>-Përfaqësimi i Kooperativave të Bujqve te palët e treta në Kosovë dhe jashtë |

**Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet**

Bashkimi i bujqve si formë e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, është faktor i zhvillimit të shpejtë të bujqësisë, mbështetje e rëndësishme e zhvillimit të prodhuesve bujqësor dhe përmirësimit të pozitës së tyre.
Përmes kooperativave, prodhuesit bujqësor kanë qasje në tregjet e reja, në informata dhe teknologji, furnizimin me material riprodhues dhe makina bujqësore dhe trajnime si dhe mund të arrijnë plasmanin e prodhimeve bujqësore pa ndërmjetësues, ndërtimin e objekteve përpunuese, blerjen e makinave moderne, marrjen e mbështetjes qeveritare, angazhimin e ekspertëve etj.

Situata aktuale krijimit dhe funksionimit të kooperativave bujqësore në Republikën e Kosovës është në nivel shumë të ultë. Derisa në shumë shtete Evropiane kooperativat e furnizojnë tregun me produktet e tyre në përqindje të madhe, në vendin tonë situata është e kundërt dhe kooperativat kanë rol minor në furnizimin e tregut me produkte bujqësore.

Pas hyrjes në fuqi Ligjit për Kooperativat e Bujqve (2003) kooperativat e deri më tani janë regjistruar gjithsejtë 61 kooperativa bujqësore. Kooperativat e para janë regjistruar në vitin 2005 dhe nga ai vit e deri në vitin 2016 (për 11 vjet) janë regjistruar 20 kooperative ndërsa nga viti 2017 e deri 2023 (për 7 vjet) janë regjistruar 41 kooperativa. Nga kjo mund të shihet se trendi i regjistrimit të kooperativave bujqësore është në rritje megjithatë kjo nuk është ndonjë tregues i zhvillimit dhe funksionalizimit të kooperativizmit pasi që numri I kooperativave të regjistruara dhe që funksionojnë është i vogël.

Në pjesë të madhe, prodhuesit dhe përpunuesit e prodhimeve bujqësore janë të fermer të vegjël, të pa organizuar dhe jo konkurrent me prodhuesit bujqësor në shtetet BE. Nder sfidat kryesore te fermerëve është gjetja e tregjeve - bashkëpunimi për gjetjen

e tregjeve. Rreth 70% e fermave ne vend kanë nen 2ha tokë bujqësore ndërsa rreth 92% kanë nen 5ha e në shumicën e rasteve ajo tokë bujqësore është e ndarë në ngastra të vogla. Dhe kjo përveç sfidave tjera i bënë jo konkurrent në tregjet rajonale dhe evropiane prandaj është e nevojshme organizimi i prodhuesve bujqësor në kooperativa dhe planifikim i përbashkët me qëllim të rritjes së vëllimit dhe kualitetit të prodhimit dhe plasmanit më të lehtë në treg.

Mungesa e interesimit të institucioneve të shtetit për këtë fushë, është reflektuar në zhvillimin e kooperativizmit. Gjithashtu nuk janë shfrytëzuar format dhe mundësitë e organizimit.

*Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

| | |
|---|---|
| **Efektet** | **<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet - Rregullat janë të pakompletuara</u>**<br><br>• Organizimi jo efektiv i Kooperativave Bujqësore bujqësore, jo në përputhje me parimet ndërkombëtare të kooperativave;<br>• Prodhim i pamjaftueshëm i produkteve bujqësore;<br>• Informata dhe njohuri ne teknologjinë e prodhimit bujqësor, përmes Shërbimeve Këshillimore;<br>• Mungesë e prodhimit kualitativ;<br>• Hulumtimi, Marketingu, si dhe konkurrueshmëria; |
| **Problemi kryesor** | **Avancimi i infrastrukturës ligjore për kooperativat bujqësore në harmoni me atë të BE-së** |
| **Shkaqet** | **<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet:</u>**<br>**Zbatimi jo i plotë i legjislacionit për kooperativat**<br><br>• Mangësitë e legjislacionit adekuat qe rregullon çështjen e organizimit te fermerëve;<br>• Mungesa e organizimit horizontal tek fermerët prodhues;<br>• Mungesa e njohurive për rritjen e cilësisë dhe sasisë se prodhuar;<br>• Mungesa e njohurive per qasje ne treg;<br><br>**<u>Rregullat janë të pakompletuara</u>**<br><br>**Ndryshimet në legjislacionin për kooperativat bujqësore**<br>• Legjislacioni për kooperativat bujqësore në Kosovë është hartuar në vitin 2003, kur është aprovuar Ligji Nr. 2003/9, i cili ndërkohë ka pasur dy herë ndryshime dhe plotësime dhe ate me Ligjin nr. 03/L-004 me të cili përveq tjerash janë ndryshuar dispozitat |

| | |
|---|---|
| | ndëshkimore dhe numri i minimal i bujqëve që nevojitet për themelimin e kooperativës nga 10 në 5 bujq dhe Ligji nr.08/l-095 me të cilin janë ndryshuar dhe plotësuar dispozitat ndëshkimore (Ligji nr.08/l-095), por jo edhe në aspektet tjera përmbajtjesore, po ashtu ligji aktual i përket kohës së institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse, prandaj ndryshimi i tij është i domosdoshëm. Ky Ligj është plotësuar ndërkohë edhe me dy Udhëzime Administrative: U/A Nr. 06/2004 për përmbajtjen e statutit dhe kushtet e regjistrimit të kooperativave të bujqve dhe U/A Nr.10/2004 për Federatën e kooperativave të bujqve të Kosovës, por të cilat nuk përmbushin nevojat dinamike aktuale për funksionimin e kooperativave bujqësore në Kosovë.<br><br>**Mangësitë në kornizën aktuale Ligjore për kooperativat**<br><br>• Mangësi në kornizën ligjore (primare dhe sekondare) ekzistuese, e cila përmban dispozita të përgjithësuara të cilat krijojnë paqartësi të bujqit;<br>  • Mangësi ligjore rreth çështjes së organizimit horizontal të fermerëve (bashkëpunim dhe funksionim) me kooperativën, sipas praktikave të vendeve të BE-së;<br>• Mungesa e mbështetjes financiare të kooperativave dhe anëtarëve të saj si përmes sistemit të përparësisë në procesin e përzgjedhjes apo vlerës së subvencionit dhe mbështetjeve tjera;<br>• Mospërfshirja e fushatave vetëdijësuese për rolin dhe rëndësinë e fermerëve në organizimin dhe administrimin e kooperativave, si dhe informimin e tyre për benificionet që mund t'i kenë në rast bashkimit në kooperativa;<br>• Paqartësi ligjore në përcaktimin e autoritetit përkatës për dhënien e këshillave profesionale (trajnimeve) për fermerët anëtarë;<br>• Mungesë ligjore në përcaktimin e autoritetit promovues, i cili ka për detyrë promovimin e produkteve bujqësore, duke filluar nga prodhimi, përpunimi, paketimi dhe shitja;<br>• Mangësi ligjore në përcaktimin e autoritetit i cili do ta mbikëqyrë funksionimin e përgjithshëm të kooperativave (financat dhe asetet e përgjithshme), përmes zbatimit të ligjit. |

**Shkaqet**

**<u>Mangësitë e legjislacionit adekuat qe rregullon çështjen e organizimit te fermerëve</u>**

Dispozitat e përgjithësuara në ligjin aktual për kooperativat bujqësore janë faktorë që krijojnë paqartësi tek fermerët dhe padyshim kanë ndikim në mosorganizimin dhe bashkëpunimin e fermerëve në vendin tonë. Njëra nga mangësitë ligjore është vërejtur tek mbështetja financiare (subvencionet dhe mbështetjet tjera), duke mos i pasur parasysh diferencimin e fermerëve anëtarë të kooperativave në raport me fermerët jo anëtarë. Ligji aktual nuk i përmban parimet themelore të kooperativave të përcaktuara me legjislacionin e BE-së për kooperativa. Po ashtu, Ligji aktual parasheh vetëm kontrollin e jashtëm financiar por jo edhe kontrollin e brendshëm i cili do të kryhej nga ndonjë organ i zgjedhur apo i caktuar nga Kuvendi i Kooperativës (ku do të përfshiheshin anëtarë dhe punëtorët të kooperativës, dhe një person jashtë kooperative) i cili, përveç kontrollit financiar do të bënte edhe kontrollin e ligjshmërisë së udhëheqjes së afarizmit të kooperativave dhe çështje tjera që caktohen me statut. Mangësi në ligjin aktual në specifikimin e shumës së kontributit aksionar me rastin e themelimit të kooperativës, pagesa e anëtarësisë si formë e krijimit të kapitalit të kooperativës si dhe kush e cakton shumen e anëtarësisë. Nuk është saktësuar qartë roli i themeluesit (aksionarit) dhe anëtarit si dhe zbatimi i parimit të barazisë në udhëheqjen e kooperativës përmes parimit "një anëtar, një votë". Sa i përket funksionit dhe rolit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit, përveç hartimit të akteve nënligjore, ligji nuk përmban asnjë dispozitë për rolin e ministrisë, siç mund të jenë: rolit mbikëqyrës I MBPZHR për zbatimin e ligjit; ofrimit i këshillave përmes shërbimeve këshillimore, ofrimi i mbështetjes së bujqve gjatë themelimit dhe viteve të para të punës së kooperativës etj. Gjithashtu nuk ka dispozita rreth zhvillimit të mekanizmave financiar për kooperativat bujqësore apo anëtarët e tyre (subvencione, kredi të buta, politika lehtësuese tatimore, etj.)

**<u>Mungesa e organizimit horizontal tek fermerët prodhues</u>**

Një ndër problemet kryesore për situatën aktuale në sektorin e bujqësisë, vazhdon të jetë edhe mungesa e Legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon çështjen e organizimit horizontal të bujqve. Andaj, në Kosovë nevojë urgjente është të promovohen institucionet (organizatat) si në çdo vend tjetër, duke përfshirë edhe zhvillimin e bujqësisë dhe industrisë përpunuese. Një prej institucioneve më të rëndësishme që kërkohet të ndihmoj promovimin dhe të jap formën e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë janë Kooperativat Bujqësore të kontrolluara dhe të menaxhuara nga vetë fermerët-anëtarë. Iniciativa e vetë fermerëve për bashkëpunim përmes organizimit të Kooperativave Bujqësore do të krijoj mundësi për furnizim me inpute bujqësore cilësore, siç janë: farërat, plehrat, ushqimet për kafshë, pajisjet bujqësore, pesticidet etj. Po ashtu, krijimi i lidhjeve në mes të fermerëve apo

organizimi horizontal i bujqve, do të krijoj hapsirë për gjetjen e tregut të përbashkët duke bërë grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, marketingun e produkteve bujqësore, dhe shitjen, si dhe shfrytëzimin e përbashkët të mekanizimit bujqësore. Përveç këtyre aktivitetevekooperativat ofrojnë edhe shërbime tjera siç janë: organizimi i trajnimeve me qëllim të aplikimit të teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore, krijimin i lidhjeve me institucionet bankare, mbrojtja e interesave të fermerëve duke avokuar për politika më të favorshme për prodhimtarinë bujqësore ndaj institucioneve vendim marrëse-qeveritare. Andaj, në mungesë të legjislacionit i cili do t'i krijoj hapsirë organizimit horizontal të fermerëve prodhues, Kosova është duke u përballur me vështirësi në rritjen e sasisë dhe kualitetit të prodhimit bujqësor. Pavarësisht përkrahjes në rritjes në çdo vit e cila është siguruar nga ana e Qeverise se Republikës së Kosovës por edhe donatorëve tjerë, prodhimi bujqësor në vendin tonë vazhdon të jetë i ulët, ndërsa importi është tejet i lartë. Andaj, mbulueshmeria e importit me eksport të produkteve bujqësore, akoma vazhdon të mbetet e ulët.

**<u>Mungesa e njohurive për rritjen e cilësisë dhe sasisë se prodhuar</u>**

Njohuritë për rritjen e cilësisë dhe sasisë se prodhuar duhet realizuar përmes Shërbimit Këshillimor i cili është i organizuar në kuadër të Misnistrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvilllimit Rural (MBPZHR) dhe në nivel komunal, por i cili më tepër ka rol organizativ, përmes së cilit duhet të shperndahen të gjitha informacionet lidhur me rolin dhe rëndësinë e produkteve bujqësore-cilësore por edhe shfrytëzimin e potencialit të tyre prodhues dhe teknologjive të kultivimit. Mirëpo, për shkak të kapaciteteve të kufizuara në personel të shërbimit këshillimor dhe mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional, shpërndarja e informacionit tek fermerët për rolin e cilësisë dhe sasisë së produkteve bujqësore të prodhuara në vendin tonë është e kufizuar. Po ashtu, duhet theksuar se rol të rëndësishëm në monitorimin e prodhimit të produkteve bujqësore-cilësore, luajnë edhe institucione tjera, siç janë: Agjensioni i Ushqimit dhe Veterisës (AUV) dhe Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) të cilat përmes monitorimit dhe inspektimit duhet bërë certifikimin e produkteve bujqësore, qofshin ato me prejardhje bimore apo shtazore. Në këtë rast, duhet theksuar se shumica e fermave në Kosovë janë ferma të vogla familjare, numri më i madh i të cilave funksionojnë në nivel të prodhimit për mbijetese, duke prodhuar të mira dhe shërbime vetëm sa për të plotësuar nevojat familjare (konsum vetanak). Si rezultat i kësaj niveli i përgjithshëm i varfërisë në Kosovë është më i larti në këto grupe të popullsisë, dhe po ashtu është shumë më i vështirë monitorimi i produkteve bujqësore për cilësi dhe sasi të prodhuar nga gjitha këto grupe. Andaj, për këtë arsye është i nevojshëm krijimi i kooperativave bujqësore, sepse produktet bujqësore të prodhuara nga fermerët do të dorëzoheshin në kooperativa, dhe të njëjtat do të kishin mundësi shumë më leht të monitoroheshin dhe certifikikoheshin.

**Mungesa e njohurive per qasje ne treg**

Përpunimi dhe tregtimi i suksesshëm i mallrave të prodhuar nga prodhuesit (fermerët anëtarë) që dorëzojnë produktet e tyre në kooperativë, realizohet duke e zhvilluar sektorin e marketingut i cili bëhet përmes bashkëpunimit. Prodhuesit mund të krijojnë edhe kooperativa marketingu për të tregtuar, shpërndarë dhe përpunuar së bashku produktet e tyre. Duke bashkuar burimet e tyre, anëtarët prodhues mund të punësojnë specialistë profesionistë të marketingut njëkohësisht edhe t'i përpunojnë produktet e tyre në fabrika. Shumë kooperativa marketingu gjithashtu lehtësojnë investimet e prodhuesve në zhvillimin e emrave të markave, kërkimin e tregut dhe zhvillimin e produkteve. Kooperativat përdorin shumë metoda për të llogaritur dhe gjurmuar mallrat e pa përpunuara të dorëzuara në objektet e tyre nga anëtarët e tyre. Shumë kooperativa përdorin marrëveshjet e marketingut si një mënyrë për të specifikuar kushtet sipas të cilave produktet do të pranohen, përpunohen ose tregtohen nga kooperativa në emër të anëtarëve të saj. Kjo i mundëson kooperativës të funksionojë në një bazë më efikase. Në grupet e marketingut kooperativë, prodhuesit e një malli specifik bashkojnë së bashku prodhimin e tyre për t'u tregtuar dhe/ose përpunuar nga kooperativa e tyre. Sipas kësaj praktike, pronësia e mallit të korrur i transferohet kooperativës dhe menaxhmenti i kooperativës përcakton kohën më të mirë për të shitur, ku të shitet dhe nëse do t'i nënshtrohet mallit të papërpunuar për përpunim të mëtejshëm. Në një kooperativë me një marrëveshje marketingu, pronësia e produktit të dorëzuar në kooperativë mbetet tek anëtari që e ka prodhuar atë. Kooperativa gjithashtu mund t'i lejojë anëtarët të vendosin një çmim minimal me të cilin malli mund të shitet. Pas përfundimit të shitjes, një pjesë e të ardhurave mbahet për të mbuluar kostot operative të kooperativës dhe për të dhënë një kontribut në kapitalin e vet. Kooperativat me një marrëveshje marketingu u ofrojnë anëtarëve të drejtën për të përcaktuar kohën e shitjes dhe në thelb funksionojnë si ndërmjetës midis blerësve dhe shitësve. Kjo shërben për të siguruar informacion mbi transaksionet për të gjithë anëtarët, duke u dhënë kështu anëtarëve fuqi më të madhe të tregut në formën e informacionit për ofertën dhe kërkesën, si dhe ndikimin e situatës së tregut në çmimet që u ofrohen prodhuesve për mallrat etyre.

**Efektet**

**Organizimi jo efektiv i Kooperativave Bujqësore bujqësore, jo në përputhje me parimet ndërkombëtare të kooperativave**

Fillimi i një kooperative është një projekt kompleks që përfshin planifikim të kujdesshëm dhe hulumtim të plotë. Objektivat janë zakonisht rezultat i një problemi ose mundësie të përbashkët. Ky kapitull paraqet katër pikat themelore të zhvillimit të kooperativës (vizioni, kapitali, anëtarët dhe organizimi), si dhe një përmbledhje prej pesë hapave bazë të përfshirë në organizimin e një biznesi kooperativist, siç janë: identifikimi i një qëllim të përbashkët ekonomik, përcaktimi i fizibilitetit të biznesit,

zhvillimin e një plan biznesi, shfrytëzimi i masave ligjore dhe inkorporomi i tyre bashkëpunimin, si dhe fillimi i operacionet për zbatimit të planit të biznesit. Çdo hap përfaqëson një pikë vlerësimi ku duhet të merret një vendim nëse do të vazhdohet apo jo me kooperativën bazuar në rezultatet dhe analizat e hulumtimit. Në mënyrë që të ndërtohet një themel i fortë për bashkëpunim, këto vendime do të kërkojnë përfshirje dhe kontribut nga sa më shumë anëtarë që të jetë e mundur. Takimet efektive janë një pjesë e rëndësishme e zhvillimit dhe funksionimit të vazhdueshëm të një biznesi kooperativë. Andaj, për formimin e një biznesi kooperativ-bashkëpunues, fermerët duhet të jenë një grup individësh të përputhshëm që ndajnë një qëllim ose qëllime të përbashkëta dhe që besojnë se mund ta arrijnë më së miri këtë qëllim ose qëllime duke punuar së bashku. Për shkak të natyrës unike të kooperativave, qëllimet mund të jenë ekonomike, sociale/kulturore dhe/ose mjedisore.

**<u>Prodhim i pamjaftueshëm i produkteve bujqësore</u>**

Prodhimi i pamjaftueshëm i produkteve bujqësore, rrjedhë si pasojë e parcelizimit të tokave bujqësore, e cila ka ndikuar në madhësinë e fermave që fillon prej: 5 deri më pak se 10 ha, përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme - arave, pasuar nga madhësia e fermave prej 2 deri më pak se 5 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%), dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha. Si pasojë këto ferma gjenerojnë shumë pak ose aspak të mira materiale që të plotësojnë nevojat e veta. Për më tepër ekziston një iniciativë shumë e vogël që të tejkalohet kjo gjendje, sepse këtyre fermave familjare u mungon qasja në kredi, dhe shërbime të tjera të biznesit. Numri më i madh i ekonomive bujqësore në Kosovë posedojnë kryesisht fermat që për nga madhësia dominojnë fermat me madhësi të vogël të sipërfaqes. Kështu që fermat me madhësi nga 0 deri më pak se 0.5 ha posedojnë 30% të ekonomive bujqësore, pasuar nga madhësia 2 deri më pak se 5 ha (23%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (22%), dhe grupet e tjera që kanë pjesëmarrje më të vogël. Numri më i vogël i ekonomive bujqësore apo 0.2% kishin ferma me madhësi 20 deri më pak se 30 ha, dhe 30 e më shumë ha paraqiten vetëm 0.2% e ekonomive bujqësore. Përshkrimi i lartcekur i sektorit të bujqësisë në Kosovë, nuk garanton zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë e cila do t'i plotësonte nevojat për prodhim të mjaftueshëm për popullatën, pa bërë ndryshime rreth formës së sistemit organizativ tek fermerët, e cila do t'i mundësonte bashkëpunim dhe zhvillim.

**<u>Informata dhe njohuri në teknologjinë e prodhimit bujqësor, përmes Shërbimeve Këshillimore</u>**

Shërbimi këshillimor në Kosovë është i organizuar në kuadër të Misnistrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvilllimit Rural (MBPZHR) dhe në nivel komunal, por i cili më tepër ka rol organizativ, përmes së cilit duhet të shpernahen të gjitha informacionet lidhur me rolin dhe rëndësinë e teknologjive të kultivimit në prodhimtarinë bujqësore.

Momentalisht, për shkak të kapaciteteve të kufizuara në personel të shërbimit këshillimor dhe mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional, shpërndarja e informacionit tek fermerët për teknologjitë e reja të prodhimit bujqësor në vendin tonë është e kufizuar, mirëpo kjo gjendje duhet të ndryshoj në të ardhmen, përmes bashkëpunimeve, rritjes së numrit të stafit profesional, si dhe trajnimeve të vazhdueshme që duhet realizuar stafi profesional i shërbimeve këshillimore, me qëllim të arrijë shpërndarjen maksimale të njohurive tek fermerët për rolin dhe rëndësinë e teknologjive të prodhimit bujqësor.

**Mungesë e prodhimit kualitativ**

Mungesa e prodhimit kualitativ të produkteve bujqësore është komponentë shumë e rëndësishme, sepse përmes zingjirit ushqyes do të reflektoj mbi sigurinë e shëndetit publikt tek popullata. Kjo komponentë është e ndrërlidhur direkt me përdorimin e inputeve bujqësore (cilësore), që nënkupton përdorimin e plehërave, farërave, fidaneve, përdorimin e pesticideve sipas kritereve apo standardeve të lejuara, si dhe mënyrën e kultivimit gjatë vegjetacionit, bazuar në kërkesat specifike të kulturave të ndryshme bujqësore.

**Hulumtimi, Marketingu, si dhe konkurrueshmëria**

Marrëveshjet e marketingut janë kontrata ndërmjet kooperativës dhe anëtarëve të saj, të cilat mund të përfitojnë si individët prodhues (anëtarët) por dhe biznesi. Për kooperativën, ato i ofrojnë menaxhmentit mjetet për të koordinuar vëllimin e biznesit me madhësinë e objekteve të disponueshme, duke i lejuar kooperativës të arrijë kostot më të ulëta të mundshme operative. Po ashtu, duhet të bëhet një përshkrim i mallrave që do të prodhohen, paketohen, përpunohen dhe/ose tregtohen nga kooperativa, duke specifikuar sasinë që do t'i dorëzohet kooperativës. Në varësi të rrethanave të veçanta, sasia që do të dorëzohet mund të përcaktohet në terma të peshës ose prodhimit (rendimentit) të një sipërfaqeje specifike, nëse kontrata është mbi bazën e sipërfaqes, kooperativa merr përsipër rrezikun e rendimentit, ndërsa bazohet në bazën e peshës së dorëzuar, prodhuesi mbart rrezikun që të mos jetë në gjendje të japë rendimentin e specifikuar. Disa kooperativa kërkojnë që të gjitha kulturat e prodhuara që tejkalojnë marrëveshjen e marketingut të shkatërrohen për të parandaluar vërshimin e tregut dhe uljen e çmimeve. Kooperativat e tjera kërkojnë që anëtarët-prodhues të dorëzojnë të gjithë mallin që prodhojnë, ndërsa të tjera ende lejojnë anëtarët të tregtojnë prodhimin e tepërt sipas gjykimit të tyre.

**Palët me interes**

*Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| Emri i palës së interesuar | Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet) |
|---|---|---|---|
| MBPZHR | - Mangësitë e legjislacionit adekuat qe rregullon çështjen e organizimit te fermerëve;<br>- Mungesa e organizimit horizontal tek fermerët prodhues;<br>- Mungesa e njohurive për rritjen e cilësisë dhe sasisë se prodhuar; | - Organizimin e kooperativave të mirëfillta bujqësore;<br>- Prodhim i pamjaftueshëm i produkteve bujqësore;<br>- Informata dhe njohuri ne teknologjinë e prodhimit bujqësor, përmes Shërbimeve Këshillimore;<br>- Mungesë e prodhimit kualitativ; | MBPZhR- është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit në përcaktimin e kritereve për themelimin e kooperativave bujqësore, mbështetjen në subvencionim dhe programeve të tjera, si dhe mbështetje në dhënien e këshillave teknike dhe profesionale. |
| Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës. | Monitorimi dhe certifikimi i produkteve bujqësore | Mbrojtja e popullatës nga produkte jo cilësore | AUV- është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe legjislacionit të hartuar nga MBPZHR, në funksion të kontrollit dhe monitorimit të përgjithshëm të procesit të sigurisë së produkteve ushqimore në nivel vendi. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Instituti Bujqësor i Kosovës | Mungesa e njohurive për rritjen e cilësisë dhe sasisë se prodhuar; | -Prodhim i pamjaftueshëm i produkteve bujqësore;<br>-Mungesë në informata rreth cilësisë së farërave, fidaneve dhe teknologjive të prodhimit bujqësor;<br>-Mungesë e prodhimit kualitativ; | IBK- është përgjegjës për realizimin e testimeve fushore dhe laboratorike të farërave, dhe materialit fidanor në shërbim të MBPZHR-së, AUV-it, por dhe palëve tjera që mund të jenë nga institucione shtetërore apo private. |
| Fakulteti Bujqësisë | Mungesa e njohurive për rritjen e cilësisë dhe sasisë se prodhuar; | - Prodhim i pamjaftueshëm i produkteve bujqësore;<br>- Mungesë në informata rreth cilësisë së farërave, fidaneve dhe teknologjive të prodhimit bujqësor;<br>- Mungesë e prodhimit kualitativ; | FBV është përgjegjës në dhënien e kontributit profesional-shkencor |
| Komunat | Mospërfshirja e fushatave vetëdijësuese | - Informata dhe njohuri ne teknologjinë e prodhimit bujqësor, përmes Shërbimeve Këshillimore;<br>- Efekt në rolin dhe rëndësinë e fermerëve në organizimin dhe administrimin e | Dretoritë Komunale të Bujqësisë, janë përgjegjëse për shpërndarjen e informacioneve lidhur me rolin dhe rëndësinë e organizimit të kooperativave bujqësore, si dhe dhënien e këshillave |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | kooperativave, si dhe informimin e tyre për benificionet që mund t'i kenë në rast bashkimit në kooperativa; | tjera teknike dhe profesionale. |
| Dogana | Kritere në pikat hyrëse-kufitare | Mund të shfaqen vonesa në inportin-eksportin qoftë të inputeve, mekanizimet apo edhe produkteve tjera bujqësore | Dogana është përgjegjëse për t'i realizuar kontrollat në pikat kufitare për secilin produkt që hyjnë apo del nga territori i Republikës së Kosovës. |
| Organizatat e fermerëve | Mungesa e njohurive per qasje ne treg | Hulumtimi, Marketingu, si dhe konkurrueshmëria | Organizatat e fermerëve mund të luaj rol në aspektin e hulumtimit dhe krijimit të çasjes në treg, në marketing, dhe konkurrueshmëri |

**Praktikat e vendeve të rajonit**

Për qëllime të këtij koncept dokumenti është analizuar Ligji i Republikës së Kosovës për Kooperativat e bujqve, legjislacioni për fushën e kooperativizmit të disa prej shteteve të rajonit, përfshi ligjet e Kroacisë, Shqipërisë dhe Serbia si dhe legjislacioni i BE-së që lidhet me kooperativat dhe bashkësitë e Kooperativave Bujqësore të BE-së (Kooperativat e BE-së).

**Republika e Kroacisë**

Kooperativizmi në Kroaci është rregulluar me Ligjin për Kooperativat, NN 34/11 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 125/1/76/14 114/18 dhe 98/19. Me këtë ligj rregullohet themelimi administrimi dhe funksionimi i të gjitha kooperativave që do të thotë se Kroacia nuk ka nxjerr ligj të veçantë për Kooperativat Bujqësore.

Me këtë ligj kooperativa përcaktohet si shoqëri vullnetare , e hapur dhe e pa varur me të cilën menaxhojnë anëtarët e saj, ku me punën dhe aktivitetet tjera apo shfrytëzimin e shërbimeve të saj, në bazë të punës dhe ndihmës së përbashkët realizojnë, përparojnë

dhe mbrojnë nevojat dhe interesat e tyre ekonomike, sociale, arsimore, kulturore etj. si dhe realizojnë qëllimet për të cilat është themeluar kooperativa.

Raportet në mes të anëtarëve të Kooperativës rregullohen në parimet e kooperativizmit:

- Anëtarësimi i hapur dhe vullnetar;
- Mbikëqyrja e afarizmit nga anëtarët;
- Pjesëmarrja e anëtarëve të kooperativës në qeverisje dhe shpërndarje;
- Vetëqeverisja dhe pavarësia;
- Arsimimi , ngritja profesionale dhe informimi i anëtarëve të kooperativës
- Kujdesi për bashkësinë.

Themelimi i Kooperativës. Kooperativën mund ta themelojnë së paku shtatë (7) themelues. Ligji rregullon, organizimin dhe aktivitetet e kuvendit themelues, përmbajtjen e aktit të përgjithshëm për themelimin e Kooperativës, regjistrimin e kooperativës (regjistrimi bëhet në regjistrin gjyqësor)

Anëtarësimi në kooperativë. Anëtar i kooperativës mund të bëhet çdo person i cili drejtpërdrejtë merr pjesë në punën e kooperativë, i cili punon përmes kooperativës, shfrytëzon shërbimet e saj apo në mënyrë tjetër drejtpërdrejt merr pjesë në realizimin e qëllimeve për të cilat kooperativa është themeluar. Anëtari i kooperativës nuk mund të bartë anëtarësinë në personin tjetër.

Themeluesi i kooperativës dhe anëtari i kooperativës i cili ka hy në kooperativë pas themelimit të saj kanë të drejta dhe obligime të njëjta.

Organet e Kooperativës janë: Kuvendi; Këshilli mbikëqyrës; dhe Drejtori

Ligji I përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit, organizimin, mbajtjen dhe mënyrën e vendosjes në mbledhjet e Kuvendit, mënyrën e votimit (çdo anëtar I kuvendit ka një votë); përbërjen dhe përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës (së paku 3 anëtar, një prej të cilëve, person i cili nuk është anëtar i Kooperativës dhe nëse kooperativa ka të punësuar, një anëtar e zgjedhin punëtorët). Kjo nën kupton se mbikëqyrja bëhet nga një organ të cilin e zgjedh Kuvendi I Kooperativës.

Pasuria e kooperativës. Pasurinë e kooperativës e përbëjnë deponimet (kontributet) e anëtarëve, mjetet e krijuara përmes ushtrimit të veprimtarisë dhe aktivitetet tjera të kooperativës dhe mjetet e fituara në mënyra tjera.

Pasuria e kooperativës i takon kooperativës dhe shërben për ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe përmbushjen e obligimeve. Pasurinë e cila nuk është në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, kooperativa mundet me vendimin e kuvendit ta shet ose ta jap me qira, ndërsa mjetet është e obliguar ti shfrytëzon për afarizmin e kooperativës.

Deponimi i anëtarëve mund të jetë bazik (paguhet me rastin e themelimit të kooperativës apo bashkëngjitjes së kooperativës pas themelimit) dhe deponimi shtesë ( paguhet përveç deponimit bazë)

Shuma e deponimit bazik dhe shtesë është i njëjtë dhe lartësinë e tij e cakton Kuvendi. Deponimi por nuk mund të jetë në shumë më të vogël se 1.000,00 kuna. Deponimi mund të jetë në sende apo të drejta vlera monetare e të cilave përcaktohet nga eksperti gjyqësor.

Deponimi i kthehet anëtarit të kooperativës, pas pushimit të anëtarësisë. Deponim të mjeteve financiare mund të bëj edh personat që nuk janë anëtar të kooperativës, për të cilët mbahet evidencë e veçantë. Me aktet e kooperativës mund të përcaktohet që anëtarët e kooperativës paguaj anëtarësinë.

Kooperativa mund të ushtron veprimtarinë me qëllim të krijimit të fitimit apo për përmbushjen e nevojave të anëtarëve të vet, pa qëllim të fitimit.

Fitimin e përcaktuar me llogarinë vjetore kooperativa e ndan: së paku 20% për zhvillimin e kooperativës, së paku 5% në kursimin e obligueshëm deri sa ai kursim e arrin shumen e përgjithshme të deponimit të anëtarëve. Shuma tjetër e fitimit, me vendimin e Kuvendit mund të regjistrohet si deponim shtesë i anëtarëve të kuvendit sipas aktiviteteve në kooperativë, për pagesë e anëtarëve të kooperativës, investuesëve dhe punëtorëve të kooperativës apo për qëllime tjera të përcaktuara me vendim të Kuvendit.

Pushimi i kooperativës. Në rast të pushimit të kooperativës për shkak të shkrirjes, bashkimit apo ndarjes së saj, të drejtat dhe obligimet barten në pasardhësit e saj. Ndërsa në rastet e likuidimit gjegjësisht falimentimit të kooperativës, pas përmbushjes së të gjitha obligimeve, pasuria e mbetur i bartet njësisë së vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilës gjendet ajo e cila mund ta bartë në pronësi të ndonjë kooperative tjetër ekzistuese, kooperative të re të krijuar apo ta shfrytëzon për zhvillimin e kooperativizmit.

Ligji përshkruan detyrat e Ministrisë për ndërmarrësi dhe qarkullim e cila është ministri përgjegjëse për kooperativa (neni 50).

Kooperativat mund të themelojnë dhe të bashkohen në lidhje të kooperativave territoriale, sektoriale apo të specializuara të cilat kanë statusin e personit juridik. Mjetet për punë, lidhja e kooperativave i siguron nga: puna dhe aktivitete e lidhjes së kooperativave, mbështetjeve, donacioneve dhe burimet tjera.

Kapitulli i IX i ligjit (nenet 57-69) ka të bëj me kooperativat të cilat kanë veçori të caktuara ku vetëm një nen (57) ka të bëjë me kooperativat bujqësore i cili përcakton se: „Kooperativa bujqësore është kooperativa e cila veprimtari kryesore e ka

kultivimin e bimëve, blegtorinë, pylltarinë ose gjuetinë apo veprimtarit shërbyese të lidhura me to...“

Mbikëqyrja. Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të kooperativave dhe dispozitave të nxjerra sipas tij e bënë Ministria përkatëse për punët e ndërmarrësisë dhe qarkullimit.

**Republika e Shqipërisë**

Republika e Shqipërisë bashkimin e bujqve me qëllim të realizimit të interesave të tyre e ka rregullua me Ligjin Nr. 38/2012 për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor i aprovuar në vitin 2012.

Në Ligj ceket se i njëjti është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit 1435/2003/KE të dt. 22.07.2001 "Mbi Statusin e shoqërive evropiane të kooperativave"

Me këtë ligj përcaktohet se: " shoqëria e bashkëpunimit bujqësor është organizim vullnetar në mes të personave fizik apo juridik me qëllim përmbushjen e nevojave apo interesave të tyre në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, kryesisht por pa u kufizuar, nëpërmjet marrëveshjeve apo bashkëpunimit të ndërsjellë në mes tyre dhe shoqërisë për shërbime, mallra apo produkte të sektorit bujqësor apo blegtoral, si dhe promovimit të veprimtarive të tyre ekonomike.

Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor janë subjekt i lehtësive fiskale dhe skemave mbështetëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Themelimi i Shoqërisë. Shoqërinë mund ta themelojnë së paku shtatë (7) anëtar. Ligji përcakton, statusin e personit juridik përmbajtjen e aktit të themelimit të shoqërisë, përmbajtjen e Statutit dhe regjistrimin e shoqërisë (regjistrimi bëhet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit)

Ligji parasheh formimin e Shoqërive të veçanta të bashkëpunimit bujqësor, në bazë të veprimtarisë që ushtrojnë si:

- Shoqëri të bashkëpunimit në fushën e prodhimit bujqësor dhe të marketingut;
- Shoqëri të bashkëpunimit në veprimtarinë e punës bujqësore;
- Shoqëri të bashkëpunimit për konsumin e lëndëve dhe mallrave;
- Shoqëri të bashkëpunimit për inputet;
- Shoqëri të bashkëpunimit për qëllime tjera në fushën e bujqësisë;

Shoqëria për detyrimet e sajë përgjigjet me të gjithë pasurinë e shoqërisë ndërsa anëtarët, përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, deri në vlerën e kontributeve të tyre.

Anëtarësimi në shoqërinë e bashkimit bujqësor. Anëtar të shoqërisë mund të jen personat fizik apo juridik të cilët përmbushin nevojat dhe interesat e tyre lidhur me veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale që ushtrojnë, nëpërmjet shërbimeve, mallrave apo produkteve të ofruara nga shoqëria. Pranimi i anëtarëve të ri bëhet me vendimin e Asamblesë së përgjithshme dhe shoqërohet me nënshkrimin dhe derdhjen e kontributit në kapitalin e shoqërisë.

Organet e shoqërisë janë: Asambleja e përgjithshme dhe Administratori

Ligji i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e asamblesë, organizimin, mbajtjen dhe mënyrën e vendosjes në mbledhjet e Asamblesë, mënyrën e votimit etj.;

Asambleja e përgjithshme mund të emëron një apo më shumë administrator për periudhë jo më të gjatë se 5 vjeçare, me të drejtë të rizgjedhjes.

Kapitali i shoqërisë. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kontributi i anëtarëve i cili mund të jetë në para apo në natyrë. Kontributi në natyrë duhet të vlerësohet në vlera monetare sipas vlerësimit të ekspertit vlerësues. Raporti i ekspertit për vlerësimin e kontributeve regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Kapitali minimal për themelimit të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Anëtarët që largohen nga shoqëria, rimbursohen për kontributet e derdhura në kapitalin e shoqërisë por pa e cenuar vlerën e kapitalit minimal të kërkuar për themelimin e shoqërisë.

Fondi i rezervës së detyrueshme dhe fondi i përballimit të riskut. Shoqëria krijon Fondin e rezervës së detyrueshme dhe fondin e përballimit të riskut. Në Fondin e rezervës së detyrueshme paguhen jo më pak se 15% e fitimit neto gjatë vitit financiar paraardhës ndërsa në fondin e përballimit të riskut paguhen më së shumti 10% e fitimit neto por pa e cenuar vlerën e kapitalit minimal të kërkuar për themelimin e shoqërisë. Pjesa tjetër e fitimit mund t'u shpërndahet anëtarëve apo të përdoret për qëllime tjera sipas përcaktimeve të statutit.

Federatat e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor. Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor mund të bashkohen në federata me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të interesave të tyre. Për themelimin e një federate duhet të bashkohen së paku tri (3) shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

Organet e Federatës janë: Asambleja e përgjithshme dhe administratorët.

**Republika e Serbisë**

Në Republikën e Serbisë është në fuqi Ligji për Kooperativat i vitit 2015 (Fletorja Zyrtare e RS nr.112/2015 e dt. 30.12.2015. Ky ligj e rregullon organizimin dhe funksionimin e kooperativave të përgjithshme- nga fusha të ndryshme, që nënkupton se RS nuk ka ligj të veçanta për kooperativat bujqësore por ligji përmban vetë disa dispozita që janë të veçanta për kooperativat bujqësore.

Sipas këtij ligji kooperativa është person juridik, i cili paraqet formë të veçantë të organizimit të personave fizik, dhe e cila me afarizmin sipas parimeve të kooperativizmit realizon interesat e veta ekonomike, sociale, kulturore etj.

Anëtari i kooperativës është person fizik i cili në tërësi apo pjesërisht e kryen afarizmin e tij përmes kooperativës, gjegjësisht i cili përmes kooperativës i shet prodhimet apo shërbimet e veta, furnizohet me prodhime apo i shfrytëzon shërbimet për kryerjen e aktiviteteve të tij.

Kooperativa fiton statusin e personit juridik me regjistrimin në regjistër që bëhet te organi kompetent për regjistrimin e subjekteve ekonomike. Kooperativa nuk mund të themelohet si shoqëri ekonomike apo si formë tjetër e organizimit e as nuk mund t ë bashkohet me shoqëri ekonomike apo person tjetër juridik. Kooperativa mund të jetë themelues i ndonjë personi juridik si dhe të themelon një apo më shumë njësi të vetat.

Kooperativat bujqësore mund të jenë të përgjithshme apo të specializuara (prodhimtari bimore, blegtori, pemëtari, perimtari, vreshtari, bletari etj.)

Kooperativat bujqësore prodhojnë grumbullojnë, përpunojnë dhe shesin prodhimet bujqësore, ushqimore dhe prodhimet tjera të kooperativës dhe anëtarëve të saj, furnizojnë anëtarët me materialin riprodhues, mjetet për prodhim, pjesë rezervë për mekanizmin bujqësor dhe mallra tjera si dhe kryejnë edhe punë tjera me interes për kooperativën.

Kooperativat gëzojnë mbrojtje të veçante të RS dhe njësive të vetëqeverisjes lokale, e cila pasqyrohet përmes nxitjes së kooperativizmit, masave ekonomike dhe bujqësore përmes dispozitave të veçanta, si dhe mundësisë së themelimit të fondeve të veçanta për zhvillimin e kooperativave apo sigurimit të fondeve nga institucionet shtetërore.

Themelimi i kooperativës. Kooperativën mund ta themelojnë së paku pesë (5) persona fizik me aftësi të veprimit, të cilët nuk i përkasin një bashkësie familjare me themeluesit tjerë, që merren me punët që janë veprimtari e kooperativës. Themeluesit mund të jenë shtetas vendor apo të huaj.

Themelimi bëhet në kuvendin themelues, me nënshkrimin e kontratës së themelimit (aktit të themelimit), aprovimin e rregullave të kooperativës dhe zgjedhjen e organeve të kooperativës.

Mjetet për themelimin dhe punën e kooperativës.

Kooperativa mund të themelohet nga kontributi apo anëtarësia e anëtarëve. Kontributi i anëtarëve mund të jetë në para apo mjete jo monetare. Kontributi në mjete jo monetare duhet të vlerësohet në vlera monetare. Kapitali themelor minimal i kooperativës është 100 dinar.

Me rregulla të kooperativës caktohet kontributi i veçantë minimal i cili mund të mos jetë i njëjtë. Një anëtar mund të ketë vetëm një kontribut.

Kooperativa mund të siguron mjetet për punë edhe vetëm nga anëtarësia e anëtarëve, lartësi e të cilës është e njëjte për të gjithë anëtarët dhe caktohet me aktet e kooperativës. Pas pushimit të statusit të kooperativës anëtarësia nuk u kthehet anëtareve.

Pasuria e kooperativës sigurohet nga , kontributi, anëtarët, mjetet e krijuar me punën dhe afarizmin e apo mjetet e fituara në format tjera të lejuara.

Nëse një pronë e pa luajtshme e kooperativës shitet, mjetet nga shitja nuk mund tu ndahen anëtarëve apo të punësuarave të kooperativës por ato shfrytëzohen sipas dispozitave të ligjit dhe statutit të kooperativave.

Kapitali i kooperativës nuk mund të zvogëlohet nën vlerën e kapitalit minimal të kërkuar për themelimin e kooperativës

Organet e kooperativës dhe vendosja. Kooperativa udhëhiqet nga anëtarët e kooperativës të cilët kanë të drejta të njëjta, në bazë të parimit "Një anëtar, një vote" në kuvendin e kooperativës.

Organet e kooperativës janë: Kuvendi, Bordi i drejtorëve, Bordi mbikëqyrës dhe Drejtori. Kooperativat me më pak se 20 anëtar mund të mos zgjedhin Bordin e drejtorëve dhe Bordin mbikëqyrës por funksionin e tyre ta kryej Kuvendi.

Kooperativa në qarkullimin juridik përgjigjet për obligimet me tërë pasurinë e vetë ndërsa anëtari i kooperativës për obligimet e kooperativës përgjigjet deri në lartësinë e depozitit të vetë.

Kooperativa mund të themelon: fondin e kooperativës, fondin rezervë apo fonde tjera.

Fitimin e përcaktuar me llogarinë vjetore kooperativa e ndan: për mbulimin e humbjeve; për fondet e destinimeve të ndryshme, nëse janë themeluar; për pagesën e fitimit të anëtarëve (varësisht nga depozitimi) përveç në rastet kur kooperativa punon me anëtarësi. Shuma e pa ndarë e fitimit bartet në vitin e ardhshëm

Format e bashkimit të kooperativave:

-Federata e Kooperativave –themelohet nga kooperativat apo federatat tjera të kooperativave sipas llojit të kooperativës dhe për territorin e caktuar. Për themelimin e Federatës së re të kooperativave duhet së paku 10 kooperativa.

- Kooperativa e përbërë paraqet formë të veçantë të organizimit të kooperativave e cila mund të themelohet prej së paku dy kooperativa.

Kontrolla e koopertivës bëhet nga Revizioni i Koperativës i cili është i obliguar për të gjitha kooperativat dhe mund të jetë e rregullt (çdo dy vjet) apo e jashtëzakonshme.

Revizionin e kooperativës e bënë Lidhja e Kooperativave/lidhja e revizionit që posedon leje të lëshuar nga ministria përgjegjëse për punët e kooperativa.

**Statusi Ligjor i Kooperativave Bujqësore në BE**

BE është udhëhequr nga Politikat e Përbashkëta Bujqësore të sajë dhe udhëzuesit e organizatave prodhuese të cilat u japim shteteve anëtare të BE-së autonomi në përcaktimin individual të organizimit dhe mbështetjes së shoqërive të prodhimtarisë bujqësore. (APC).

Në BE ka disa forma të ligjeve kombëtare për kooperativat e që mund të grupohen në së paku gjatë modele formalisht të ndryshme të legjislacionit si:

- Nuk ka ligj për kooperativat (Irlanda)
- Rregullore për kooperativat si akt i pa varur formal (Austria, Gjermania);
- Rregullore për kooperativat sipas Kodit Komercial (Republika çeke, Sllovakia);
- Rregullore për Kooperativat sipas Ligjit për ndërmarrjet (Luksemburgu) apo Kodin për Ndërmarrje (Belgjika);
- Rregullore për kooperativa sipas Kodit Civil (Italia; Holanda);
- Rregullore për kooperativa sipas Kodit për Kooperativat (Portugalia);

Numri minimal i anëtarëve të kooperativës, nuk kërkohet gjithmonë me ligj. Disa shtet nuk kanë dispozita ligjore mandatore për këtë çështje (si p.sh. Belgjika, Danimarka, Luksemburgu) derisa shtetet tjera kërkojnë prezencën e së paku tre anëtarëve (Gjermani, Suedia etj.) ndërsa të tjerat kërkojnë më shumë: Polonia 10 persona fizik apo tri subjekte juridike.

Shtetet anëtare të BE-ë kanë forma të ndryshme të organizimit të kooperativave bujqësore, ndonëse parimet bazë të organizimit dhe funksionimit janë të rregulluara me Direktivën e Këshillit të Evropës.

Janë tri nivele të organizimit të kooperativave në BE dhe atë:

- Forma e thjeshtë e bashkimit
- Kooperativa për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe
- Kooperativat kombëtare apo regjionale (prodhimi, përpunimi dhe marketingu)

Legjislacioni i BE-së për Kooperativa Bujqësore Evropiane

- Direktiva e Këshillit 2003/72/EC e dt. 22 korrik 2003 për zbatimin e Statutit e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave

- Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1435/2003 e dt. 22 korrik 2003 për Statutin e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave

Parimet themelore të kooperativave në shtetet e BE-së janë:

- Anëtarësimi vullnetar dhe i hapur
- Udhëheqja demokratike e anëtarëve
- Anëtarët janë pronar, ata e kontrollojnë kooperativën dhe asetet e saj
- Organizatë autonome dhe e pa varur
- Bashkëpunimi në mes kooperativave
- Kujdesi i Kooperativat për komunitetin e tyre.

Sipas Rregullores së Këshillit të Evropës (EC) nr.1435/2003 e dt. 22 korrik 2003 për Statutin e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave, kooperativa është asociacion i pa varur i njerëzve të cilët bashkohen në baza vullnetare për përmbushjen e nevojave të tyre ekonomike sociale përmes pronësisë së përbashkët dhe kontrollit demokratik. Kooperativat dalloj në shumë elemente nga ndërmarrjet fitim prurëse si nga mënyra e marrjes së vendimeve për shkak të parimit "një anëtar, një votë" ose limitimit të numrit të votave të një anëtari individual, aksionet e anëtarëve individual në kapitalin e aksioneve janë të njëjta, kthimi i fitimit është i limituar dhe proporcional etj.

Anëtari I kooperativës evropiane është përgjegjës për obligimet e kooperativës deri në nivelin e aksioneve të paguara nëse nuk është paraparë ndryshe me statut.

Kooperativën evropiane mund ta themelojnë pesë (5) apo më shumë persona fizik që kanë vendbanimin në së paku dy shtete evropiane; pesë (5) apo më shumë persona fizik apo persona juridik, që kanë vendbanimin apo janë të regjistruar në së paku dy shtete evropiane.

Organet e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave janë: Kuvendi, Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Menaxhues apo vetëm Kuvendi dhe Bordi mbikëqyrës.

**Republika e Italisë**

Italia si vend anëtar i Bashkimit Evropian (BE) aplikon legjislacion evropian për bujqësi. Legjislacioni bazë që rregullon çështjen e organizimit të organizatave prodhuese dhe kooperativave bujqësore, është Rregullorja e BE nr.2021/2115, e miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli.

Kjo rregullore është plotësuar me rregulloren e deleguar nga komisioni i Bashkimit Evropian (BE) 2022/126 e datës 7 dhjetor 2021 duke plotësuar Rregulloren (BE)

2021/2115 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit me kërkesa shtesë për disa lloje ndërhyrjesh të specifikuara nga Shtetet Anëtare në planet e tyre strategjike CAP për periudhën 2023-2027 sipas asaj Rregulloreje si dhe rregullave mbi raportin për gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore (GAEC) standardi 1.

Kjo Rregullore parasheh rregullat e mbështetjes për bujqit e organizuar ne forme te organizatës se prodhuesve si dhe kooperativave bujqësore.

Sipas Legjislacionit ne fjale, për te themeluar një kooperativë bujqësore, duhet qe se paku 15 fermerë me një qarkullim vjetor prej 4.5 milion euro, te vendosin themelimin e saj.

Legjislacioni evropian kërkon që para themelimit, grupi i fermerëve të definoj kulturën/kulturat bujqësore për të cilat dëshiron të themeloj kooperativën bujqësore.

Kriteret e veçanta qe aplikohen me këtë legjislacion janë:

- Anëtar i kooperativës bujqësore mundet me qene vetëm prodhuesi bujqësor i asaj kulture bujqësore;
- Një fermerë nuk lejohet te jete anëtare ne me shume se ne një kooperative bujqësore me produktin e njëjtë bujqësor;
- Praktikat e Italisë veriore ishin qe shumica e aktiviteteve te kooperativës te jete e lidhur me anëtaret e përhershëm te kooperativës. Vetëm në një % te ulet (max.5 %) lejohej te bashkëpunonin me fermerë jo anëtar;
- Anëtarësimi në një kooperative bujqësore behej përmes pagesës se tarifës se regjistrimit;
- Ne rast se njeri prej anëtareve vendos te dale nga kooperativa, te njëjtit mund t'i kthehet një pjese e pagese se tij për tarifën e regjistrimit, por jo me shume se ajo shume e paguar;
- Pasuria e krijuar (investimet ne objekte te paluajtshme, pajisje, pronësia intelektuale, emërtimi gjeografik, etj) mbesin prone e kooperativës dhe nuk mund te tjetërsohen nga ana e anëtarit qe dele nga kooperativa;
- Asnjë anëtar i kooperativës nuk ka te drejte te shesë aksionet e tij tek një anëtar tjetër i kooperativës apo ndonjë anëtari te ri potencial te kooperativës;
- Bashkimi evropian mbështetë me fonde aktivitetet e kooperativave bujqësore, me kusht qe investimet qe planifikohen, marrin parasysh një varg faktorësh qe përfshijnë mbrojtjen e ambientit, zvogëlimin e emetimit te dyoksidit te karbonit, etj.;
- Tek modeli i kooperativave bujqësore ne Tirolin e Jugut, nuk ekziston modeli i transaksionit shitblerës ne mes te fermerit dhe kooperativës, pasi anëtarët e kooperativës nuk ja shesin frutat e tyre kooperativës, por kooperativa i pranon ne ruajtje dhe i shet tek palët e treta, me çka krijon vlere te shtuar për anëtarin e kooperativës. Kooperativa i mbulon shpenzimet e operimit te saj, ne baze te një

buxheti paraprakisht te aprovuar nga ana e Kuvendit te Kooperativës dhe ku te ardhurat vijnë nga një pjese e frutave te shitura te fermerëve. Pjesa tjetër i paguhet fermerit;
- Përvoja nga Italia veriore tregon nevojën për vendosjen e kritereve te qarta dhe strikte sa i përket mënyrës se organizimit dhe regjistrimit te kooperativave bujqësore ne te ardhmen, me qellim te shmangies se regjistrimit te kooperativave shume te vogla dhe jo ekonomikisht te qëndrueshme.

## Republika e Maqedonisë Veriore

Përvoja e Kooperativave Bujqësore në Maqedoninë e Veriut tregon për nevojën e përmirësimit të të gjitha tri niveleve të ekosistemit të kooperativave bujqësore:

- **Makro niveli i politikave** - ndërtimi i kapacitetit të MBPEU-së me qëllim që të aftësohet për kryerjen e rolit kryesor i cili i nevojitet sektorit të kooperativave bujqësore;
- **Niveli mezo** - nga ana publike, ekzistojnë Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë (ANZHB), Grupet e Punës Nënsektoriale (GPNS) dhe Fakulteti;
- **Niveli mikro** - gjithashtu ka mangësi: frangmentimi, dimensionet e vogla, efikasiteti i ulët dhe bashkëpunimi i kufizuar janë karakteristikat kryesore të kooperativave bujqësore gjë që rezultoi me qasje të kufizuar drejt financave, tregut dhe teknologjisë.

Po ashtu, Kooperativat Bujqësore në Maqedoninë e Veriut bazohen në pesë fusha dhe qëllime strategjike relevante, të paraqitura si në vijim:

**Fusha 1:** Konkurrueshmëri dhe efikasitet: aspekti teknologjik dhe financiar i kooperativave bujqësore

- Qëllimi 1.1. Kooperativat bujqësore kanë qasje të lehtë në teknologji, njohuri dhe inovacione dhe e përmirësojnë efikasitetin e tyre dhe teknikat e menaxhimit.
- Qëllimi 1.2. Kooperativat bujqësore kanë qasje të lehtë dhe stabile në treg dhe janë pjesë e organizimit të përbashkët tregtar në Maqedoninë e Veriut.
- Qëllimi 1.3. Kooperativat bujqësore kanë qasje të lehtë në financa.

**Fusha 2:** Efektiviteti i intervenimeve qeveritare dhe pjesëmarrja publike: aspektet ideologjike dhe politike të kooperativave bujqësore.

- Qëllimi 2.1. Kombinimi i politikave, korniza ligjore dhe ideologjia që të krijohet ekosistem i volitshëm për kooperativat bujqësore dhe që të mbështetet konkurrueshmëria e tyre gjatë procesit të qasjes drejt BE-së.
- Qëllimi 2.2. Krijimi i sistemit në të cilin janë të integruar tri nivele të ekosistemeve të kooperativave bujqësore: institucione publike (makro), shërbime (meso), kooperativa dhe bujq (mikro).

**Fusha 3:** Kooperativat bujqësore dhe shoqëria janë duke punuar së bashku për rritje të qëndrueshme: aspektet sociale të kooperativave bujqësore.

- Qëllimi 3.1. Rol i përmirësuar social i kooperativave bujqësore për përmirësimin e të ardhurave të nevojshme për jetën anëtarëve dhe bashkësitë e tyre rurale.

**Fusha 4:** Përqendrimi në ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmërinë ekologjike: aspektet ekologjike të kooperativave bujqësore.

- Qëllimi 4.1. Në ekosistemin e kooperativave bujqësore janë vendosur masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe parandalimin e ndryshimeve klimatike.

**Fusha 5:** Qasja në komunikime, media dhe digjitalizim: aspektet mediatike të kooperativave bujqësore

- Qëllimi 5.1: Kooperativat bujqësore kanë qasje të lehtë në platformën e integruar në të cilën janë të kombinuara sistemet mediatike dhe komunikuese bashkëkohore dhe informacionet relevante.

## Kapitulli 2: Objektivat

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

<table>
<tr><td colspan="2">Qëllimi i përgjithshëm i politikës – Avancimi i politikave për kooperativat bujqësore në harmoni me atë të BE-së</td></tr>
<tr><td>Objektivi Strategjik:<br><br>Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë përmes organizimit të fermerëve në kooperativa bujqësore duke e përmirësuar pozitën e tyre përmes qasjes në tregjet e reja, inpute dhe mekanizim bujqësore, si dhe trajnime profesionale.<br><br>Objektivat Specifike:<br><br>• Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative për Kooperativat Bujqësore;<br>• Mbështetja institucionale dhe organizimi i fermerëve për tu anëtarësuar në kooperativa bujqësore;</td><td>Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:<br>-1.8 Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi<br>-Masa Strategjike: Zhvillimi i bizneseve të zonave rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale<br><br>Aktiviteti – Hartimi i Koncept Dokumentit për Kooperativat Bujqësore<br><br>Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br>2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural<br>2.10. 2 Rritja e konkurrencës në sektorit agro-ushqimor<br>Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| <ul><li>Menaxhimi i kooperativës bujqësore dhe bashkëpunimi me fermerë;</li><li>Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e Kooperativave Bujqësore;</li></ul> | **Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik**<br>**Qëllimi Zhvillimor: Përmirësimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi;**<br><br>**Qëllimi Strategjik: Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë;** |
| **Objektivat specifike Opsioni 2:**<ul><li>Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit;</li><li>Mbështetja financiare e kooperativave dhe anëtarëve të saj;</li><li>Vetëdijesimi i fermerëve për rëndësinë e Kooperativave Bujqësore.</li></ul> | Të hartuara për nevojat e këtij KD |
| **Objektivat specifike Opsioni 3:**<ul><li>Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative për Kooperativat Bujqësore;</li><li>Mbështetja institucionale dhe organizimi i fermerëve për tu anëtarësuar në kooperativa bujqësore;</li><li>Menaxhimi i kooperativës bujqësore dhe bashkëpunimi me fermerë;</li><li>Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e Kooperativave Bujqësore;</li><li>Ngritja e kapaciteteve për palët e interesuara të kooperativave bujqësore;</li></ul> | Të hartuara për nevojat e këtij KD |

## Kapitulli 3: Opsionet

Koncept Dokumenti trajton tre opsione kryesore lidhur me rishikimin e kornizës ligjore në fushën e kooperativave bujqësore. Opsioni *pa asnjë ndryshim* i cili parasheh

ruajtjen e *status quo*; opsioni për *përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës ligjore* i cili nuk parasheh ndryshime legjislative mirëpo fokusohet në zbatimin e ligjeve të cilat veçse ekzistojnë; dhe së fundi opsioni me *ndryshime legjislative* i cili parasheh ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore në fushën e kooperativave bujqësore.

**Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim**

Opsioni asnjë ndryshim nënkupton që nuk do të merren kurrfarë masa as zbatuese dhe as legjislative për të adresuar problemin kryesor të shpjeguar më lartë dhe çështjet që trajtohen në këtë Koncept Dokument të mbeten kështu siç janë aktualisht të rregulluara .

Me opsionin pa asnjë ndryshim do të vazhdonte të ekzistoj problemi kryesor lidhur me mangësitë në legjislacionit për kooperativat bujqësore Rrjedhimisht, efektet të cilat mund t'i prodhojnë mangësitë e trajtuara në këtë koncept dokument, do të ndikojnë negativisht në bashkimin e bujqve përmes themelimit të kooperativave bujqësore dhe funksionalizimin efikas të tyre.

Rrjedhimisht, prezenca e këtyre mangësive në kornizën ligjore dhe në masat zbatuese të do të kenë ndikim negativ në prodhimtarinë bujqësore, qasjen e prodhuesve bujqësor në tregjet e reja dhe plasmanin e prodhimeve bujqësore pa ndërmjetësues, në informata dhe teknologji, furnizimin me material riprodhues dhe makina bujqësore, trajnime. etj.

**Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit**

Organizimi i bujqve në Kooperativa dhe zbatimi i legjislacionit aktual është dobët. Ky konstatim del nga numri i kooperativave bujqësore funksionale që nga hyrja në fuqi e ligjit.

Disa nga problemet sa i përket themelimit dhe funksionalizimit të kooperativave bujqësore do të mund të tejkaloheshin edhe pa ndryshimin e legjislacionit ekzistues por me një angazhim më të madh dhe më të vendosur të mekanizmave zbatues të ligjit, para së gjithash të MBPZHR, Shërbimeve Këshillimore e të tjera për çështje si: mbështetja financiare e kooperativave dhe anëtarëve të saj, përmes politikave dhe legjislacionit të zhvillimit të bujqësisë, ofrimi i shërbimeve këshillimeve për kooperativa dhe për bujq për organizimin dhe administrimin e kooperativave, informimin e bujqve/fushatave vetëdijsuese për rëndësinë dhe përfitimet e bashkimit në kooperativa etj.

Megjithatë problemet që janë identifikuara në këtë Koncept Dokument nuk janë vetëm të natyrës zbatuese dhe ekzekutuese por një numër i konsiderueshëm i tyre janë

të ndërlidhura me bazën aktuale ligjore. Rrjedhimisht, çfarëdo përmirësimi në zbatimin dhe ekzekutimin e dispozitave përkatëse ligjore nuk do të prodhonte zgjidhje të plotë për problemet e identifikuara. Andaj, ky opsion nuk është i rekomanduar.

**Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë, ndryshimi i politikës ekzistuese**

Opsioni i tretë është ndryshimi i politikës aktuale përmes nxjerrjes së Projekt Ligjit të ri për kooperativat bujqësore me qëllim që të adresohen mangësitë e ligjit aktual dhe problemet e identifikuara në zbatimin e këtij ligji dhe të transpozohen konceptet dhe parimet e legjislacionit të BE-së.

Ligji i ri mund të përfaqësojë një hap konkret përpara për të forcuar rolin e kooperativave bujqësore në Kosovë, duke mbajtur qëndrim të qartë në favor të tyre dhe duke dalluar qartë kooperativat bujqësore nga çdo lloj tjetër biznesi.

Elementet kryesore që duhet të marrë në konsideratë ligji i ri për kooperativat bujqësore janë përshkruar në tabelën e mëposhtme.

| Pika kyçe | Justifikim |
|---|---|
| **Deklaratë zyrtare e interesit publik të kooperativave bujqësore** | Ligji i ri është rasti për të shpallur kooperativat bujqësore si nisma me interes të përgjithshëm dhe instrumente efektive për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social, forcimin e demokracisë dhe shpërndarjen më të drejtë të pasurisë në sektorin e bujqësisë.<br>Këtu duhen përshkruar edhe vlerat e bashkëpunimit. Sipas ICA, kooperativat bazohen në vlerat e vetë-ndihmës, vetëpërgjegjësisë, demokracisë, barazisë, barazisë dhe solidaritetit. Në traditën e themeluesve të tyre, anëtarët e kooperativës besojnë në vlerat etike të ndershmërisë, çiltërsisë, përgjegjësisë sociale dhe kujdesit për të tjerët.<br>Ligji duhet të sqarojë se shteti do të garantojë dhe promovojë kushtetutën, zhvillimin e lirë, forcimin dhe autonominë e kooperativave bujqësore, në të gjitha shprehjet e tyre ekonomike dhe sociale.<br>Për rëndësinë e tyre, këto dispozita, të cilat duhet të vendosen në fillim të ligjit të ri, do të përshtateshin në mënyrë të përkryer në një ligj të përgjithshëm për kooperativat. Duke marrë |

| | |
|---|---|
| | parasysh situatën në Kosovë dhe mundësinë që ofron ligji i ri, mund të fillojmë nga këtu. |
| **Referim në parimet ndërkombëtare të kooperativave të ICA-s** | Parimet e ICA-s janë pikat kryesore të kooperativave, duke përfshirë kooperativat bujqësore, për të udhëhequr rritjen e tyre dhe për të disiplinuar funksionimin e tyre. Parimet e bashkëpunimit të ICA-së përshkruhen në kutinë e tekstit poshtë kësaj tabele. |
| **Sqarimi i përkufizimit të kooperativës** | Në përkufizimin e përgjithshëm të ICA-s, një kooperativë është një shoqatë autonome personash të bashkuar vullnetarisht për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre të përbashkëta ekonomike, sociale dhe kulturore përmes një sipërmarrjeje të përbashkët dhe të kontrolluar në mënyrë demokratike. Kjo mund t'i përshtatet fushës së ligjit për kooperativat bujqësore duke thënë, për shembull: një kooperativë bujqësore është një shoqatë autonome e fermerëve të bashkuar vullnetarisht për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre të përbashkëta ekonomike, sociale dhe kulturore nëpërmjet një ndërmarrje në pronësi dhe të kontrolluar në mënyrë demokratike. |
| **Përforcimi i tipareve të ndryshme të kooperativave bujqësore të disiplinuara nga ligji i ri në krahasim me kooperativat e mëparshme.** | Sqarimi i pjesëmarrjes vullnetare të fermerëve në çdo kooperativë dhe mungesa e ndonjë detyrimi të paracaktuar për t'i dorëzuar asetet e tyre kooperativës është thelbësore për të krijuar një mjedis të favorshëm për kooperativat bujqësore dhe për të tërhequr fermerët drejt tyre.. |
| **Konfirmimi i qëllimit reciprok të kooperativave bujqësore** | Qëllimi reciprok (75% e transaksioneve të një kooperativë fermerësh me anëtarët) është tashmë në ligjin ekzistues dhe duhet të konfirmohet. |
| **Duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet kooperativave bujqësore dhe nevojën e promovimit të tyre** | Bashkëpunimi ndërmjet kooperativave bujqësore duhet të promovohet me parashikimin zyrtar të krijimit të sindikatave të kooperativave. Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë promovimi i kooperativave bujqësore, duke përfshirë sigurimin e komunikimit, trajnimit dhe kërkimit në lidhje me kooperativat bujqësore, duke theksuar rolin e Federatës së Kooperativave. Përfshirja e këtyre elementeve në ligj është e |

| | |
|---|---|
| | rëndësishme për t'i legjitimuar ato dhe për t'i hapur terren mbështetjen e rekomanduar publike.. |
| **Identifikimi i qartë i autoritetit drejtues të kooperativave bujqësore** | Përmes departamenteve të saj të dedikuara, MBPZHR është autoriteti përgjegjës për disiplinën dhe udhëzimin e kooperativave bujqësore, lidhur me politikat, disiplinën dhe asistencën teknike. Kjo duhet të gjejë referencë në ligj dhe të shtjellohet më tej përmes udhëzimit administrativ specifik, ku do të analizohen dhe sqarohen funksionet e detajuara të departamenteve të MBPZHR. Është evidente ndërlidhja e rolit të MBPZHR-së me promovimin e kooperativave bujqësore në bashkëpunim me Federatën e Kooperativave. Ligji i ri do të propozojë masa për të integruar dhe koordinuar aktivitetet e MBPZHR dhe ato të Federatës së Kooperativave në lidhje me promovimin e kooperativave bujqësore. |
| **Krijimi i një sfondi ligjor për mbështetjen publike të kooperativave bujqësore.** | Veçanërisht në fazën e parë të rritjes së pritshme të kooperativave bujqësore, këto të fundit do të përfitojnë nga mbështetja publike, të cilën ligji i ri duhet ta miratojë dhe stimulojë me dispozitat e duhura në lidhje me promovimin, bashkëpunimin, asistencën teknike të përkushtuar, prioritetet në strategjinë bujqësore dhe rurale. masat e zhvillimit. Duhet të merret parasysh edhe lidhja ligjore ndërmjet kooperativave bujqësore dhe modelit të organizimit të prodhuesve të promovuar nga ligji i fundit për organizimin e tregut që mund të miratojnë kooperativat bujqësore. |

**PRINCIPET E KOOPERATIVAVE**

Parimet e kooperativës janë udhëzime me të cilat kooperativat i vënë në praktikë vlerat e tyre.

**1. Anëtarësimi vullnetar dhe i hapur**

Kooperativat janë organizata vullnetare, të hapura për të gjithë personat në gjendje të përdorin shërbimet e tyre dhe të gatshëm të pranojnë përgjegjësitë e anëtarësimit, pa diskriminim gjinor, social, racor, politik apo fetar.

**2. Kontrolli Demokratik i Anëtarëve**

Kooperativat janë organizata demokratike të kontrolluara nga anëtarët e tyre, të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive në përcaktimin e politikave të tyre dhe në marrjen e vendimeve. Burrat dhe gratë që shërbejnë si përfaqësues të zgjedhur janë përgjegjës para anëtarësimit. Në kooperativat parësore anëtarët kanë të drejta të barabarta votimi (një anëtar, një votë) dhe kooperativat e niveleve të tjera janë gjithashtu të organizuara në mënyrë demokratike.

**3. Pjesëmarrja ekonomike e anëtarëve**

Anëtarët kontribuojnë në mënyrë të barabartë dhe kontrollojnë në mënyrë demokratike kapitalin e kooperativës së tyre. Të paktën një pjesë e atij kapitali është zakonisht pronë e përbashkët e kooperativës. Anëtarët zakonisht marrin kompensim të kufizuar, nëse ka, mbi kapitalin e nënshkruar si kusht anëtarësimi. Anëtarët ndajnë tepricat për një ose të gjitha qëllimet e mëposhtme: zhvillimin e kooperativës së tyre, mundësisht duke krijuar rezerva, një pjesë e të cilave të paktën do të ishte e pandashme; përfitimi i anëtarëve në raport me transaksionet e tyre me kooperativën; dhe mbështetjen e aktiviteteve të tjera të miratuara nga anëtarësia.

**4. Autonomia dhe Pavarësia**

Kooperativat janë organizata autonome, vetëndihmëse të kontrolluara nga anëtarët e tyre. Nëse ata hyjnë në marrëveshje me organizata të tjera, duke përfshirë qeveritë, ose mbledhin kapital nga burime të jashtme, ata e bëjnë këtë me kushte që sigurojnë kontroll demokratik nga anëtarët e tyre dhe ruajnë autonominë e tyre bashkëpunuese.

**5. Edukimi, trajnimi dhe informacioni**

Kooperativat ofrojnë edukim dhe trajnim për anëtarët e tyre, përfaqësuesit e zgjedhur, menaxherët dhe punonjësit në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e kooperativave të tyre. Ata informojnë publikun e gjerë - veçanërisht të rinjtë dhe drejtuesit e opinionit - për natyrën dhe përfitimet e bashkëpunimit.

**6. Bashkëpunimi ndërmjet Kooperativave**

Kooperativat u shërbejnë anëtarëve të tyre në mënyrë më efektive dhe forcojnë lëvizjen kooperative duke punuar së bashku përmes strukturave lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

**7. Shqetësimi për Komunitetin**

Kooperativat punojnë për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve të tyre përmes politikave të miratuara nga anëtarët e tyre.

Me Projekt Ligjin e ri për Kooperativat bujqësore do të përfshiheshin dispozitat me të cilat do të rregulloheshin çështjet vijuese:

- Rregullimin e mangësive dhe zbrazësirave në kornizën ligjore (primare dhe sekondare), apo rregullimin e dispozitave të përgjithshme të cilat krijojnë paqartësi të bujqit;
- Specifikimi dhe qartësimi i kontributit aksionar me rastin e themelimit të kooperativës, pagesës së anëtarësisë si formë e krijimit të kapitalit të kooperativës si dhe kush e cakton shumën e anëtarësisë;
- Qartësimi i rolit të themeluesit (aksionarit) dhe anëtarit si dhe zbatimi i parimit të barazisë në udhëheqjen e kooperativës përmes parimit "një anëtar, një votë";
- Rregullimin e çështjes së organizimit horizontal të fermerëve (bashkëpunim dhe funksionim) me kooperativën, sipas praktikave të vendeve të BE-së;
- Mbështetja financiare e kooperativave, (përmes granteve) dhe anëtarëve të saj (përmes subvencioneve), përmes sistemit të përparësisë në procesin e përzgjedhjes apo vlerës së subvencionit dhe mbështetjeve tjera;
- Përcaktimin e autoritetit në MBPZHR (brenda DSHKT), i cili do ta mbikëqyrë funksionimin e përgjithshëm të kooperativave (financat dhe asetet e përgjithshme), përmes zbatimit të ligjit;
- Përforcimi i kontrollit të ligjshmërisë dhe atij financiar. Përveç kontrollin të jashtëm të ketë edhe kontroll të brendshëm i cili do të kryhej nga ndonjë organ i zgjedhur apo i caktuar nga Kuvendi i Kooperativës (ku do të përfshiheshin anëtarë dhe punëtorët të kooperativës, dhe një person jashtë kooperative ) i cili, përveç kontrollit financiar do të bënte edhe kontrollin e ligjshmërisë së udhëheqjes së afarizmit të kooperativave dhe çështje tjera që caktohen me statut;
- Përcaktimin e autoritetit promovues, i cili ka për detyrë promovimin e produkteve bujqësore, duke filluar nga prodhimi, përpunimi, paketimi dhe shitja;
- Shtimi i dispozitave për funksionin dhe roli i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në zbatimin e ligjit;
- Ofrimit i këshillave përmes shërbimeve këshillimore dhe mbështetjes së bujqve gjatë themelimit dhe viteve të para të punës së kooperativës;
- Ofrimi i informacioneve tek fermerët përmes fushatave vetëdijsuese për rëndësinë dhe përfitimet e bashkimit në kooperativa,
- Përafrimi me legjislacionin e BE-së për kooperativat bujqësore;
- Shfrytëzimi i parimeve themelore të kooperativave në shtetet e BE-së dhe dispozitat themelore të organizimit të kooperativave sipas parimit të kooperativizmit.
- Direktivat e BE-së për Kooperativat Bujqësore përfshinë:

- Direktiva e Këshillit 2003/72/EC e dt. 22 korrik 2003 për zbatimin e Statutit të Shoqërisë Evropiane të Kooperativave;
- Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1435/2003 e dt. 22 korrik 2003 për Statutin e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave.

**Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të Ligjit të ri**

Vendet e rajonit, legjislacioni i të cilave është analizuar, kanë legjislacion përafërsisht të ngjashëm për kooperativat bujqësore për shumë çështje që rregullohen me këto ligje dhe pjesërisht të ngjashëm edhe me legjislacionin e BE-së për kooperativat si p.sh. Republika e Shqipërisë ka bërë trans pozimin e pjesshëm të legjislacionit të BE-së në ligjin e sajë.

Disa nga praktikat e legjislacionit t vendeve të rajonit të cilat mund të merren parasysh gjatë hartimit të Ligjit të ri, por pa u kufizuar vetëm në to janë:

- **Parimet themelore të kooperativave të përcaktuara me legjislacionin e BE-së për kooperativa** (Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1435/2003 e për Statutin e Shoqërisë Evropiane të Kooperativave) janë të përfshira në Ligjin e R. së Shqipërisë, Ligjin e R. së Kroacisë, Rregullorja e BE-së dhe një pjesë e tyre edhe në Ligjin e R. së Serbisë.
- **Anëtarësimi i hapur dhe vullnetar sipas ligjit të Republikës së Kroacisë** - anëtar i kooperativës mund të bëhet çdo person i cili drejtpërdrejtë merr pjesë në punën e kooperativë, punon përmes kooperativës, shfrytëzon shërbimet e saj apo në mënyrë tjetër drejtpërdrejt merr pjesë në realizimin e qëllimeve për të cilat kooperativa është themeluar. Gjithashtu anëtarësimi i hapur dhe vullnetar parashihet edhe në Rregulloren e Këshillit të Evropës (EC) nr.1435/2003.
- **Të drejtat dhe obligime të njëjta të themeluesit të kooperativës dhe anëtarit të kooperativës i cili ka hy në kooperativë pas themelimit të saj.** Zbatimi i parimit të barazisë në udhëheqjen e kooperativës përmes parimit "një anëtar, një votë" në Kuvendin e Kooperativës pavarësisht nga shuma e kontributit - Rregullores e Këshillit të Evropës (EC) nr.1435/2003: Ligji i R. së Shqipërisë; Ligji i R. së Serbisë.
- **Kontrollin e brendshëm në Republikën e Kroacisë** - kontrolli i brendshëm kryhet nga një organ i zgjedhur apo i caktuar nga Kuvendi i Kooperativës (ku përfshiheshin anëtarë dhe punëtorët të kooperativës, dhe një person jashtë kooperative) i cili përveç kontrollit financiare bënë edhe kontrollin e ligjshmërisë së udhëheqjes së afarizmit të kooperativave dhe çështje tjera që caktohen me statut.
- **Në Republikën e Serbisë kontrolli i kooperativës** - bëhet nga Revizioni i Kooperativës i cili është i obliguar për të gjitha kooperativat dhe mund të jetë kontroll e rregullt (çdo dy vjet) apo e jashtëzakonshme. Revizionin e kooperativës e bënë Lidhja e Kooperativave/lidhja e revizionit që posedon leje të lëshuar nga ministria përgjegjëse për punët e kooperativa.

- **Mbështetja financiare në Republikën e Shqipërisë** - me Ligj parashihet se Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor janë subjekt i lehtësive fiskale dhe skemave mbështetëse, sipas legjislacionit në fuqi.
- **Republika e Maqedonisë Veriore**, parasheh masa stimuluese që promovojnë përfshirjen e fermerëve në kooperativa përmes diferencimit të fermerëve anëtarë të kooperativave në raport me fermerët jo anëtarë për subvencione dhe mbështetje tjera financiare.
- **Në Republikën e Serbisë, kooperativat gëzojnë mbrojtje të veçantë** - e cila pasqyrohet përmes nxitjes së kooperativizmit, masave ekonomike dhe bujqësore përmes dispozitave të veçanta, si dhe mundësisë së themelimit të fondeve të veçanta për zhvillimin e kooperativave apo sigurimit të fondeve nga institucionet shtetërore.
- **Themelimi i kooperativës së përgjithshme apo kooperativave të veçanta/sektoriale.** Disa nga shtete legjislacioni i të cilave është analizuar kanë ligj të përgjithshëm të kooperativave por i cili përmban dispozita të veçanta për kooperativat bujqësore me të cilat parashihet themelimi i kooperativave të veçanta/sektoriale si: R. e Kroacisë- kooperativa të veçanta sipas veprimtarisë që e ushtrojnë e që mund të jetë: kultivimi i bimëve, blegtoria, pylltaria, gjuetia apo veprimtarit shërbyese të lidhura me to; - R. e Serbisë -kooperativat bujqësore mund të jenë të përgjithshme apo të specializuara (prodhimtari bimore, blegtori, pemëtari, perimtari, vreshtari, bletari etj.
- **Republika e Shqipërisë parasheh formimin e Shoqërive të veçanta** të bashkëpunimit bujqësor, në bazë të veprimtarisë që ushtrojnë si në fushën e: prodhimit bujqësor dhe të marketingut; veprimtarinë e punës bujqësore; konsumin e lëndëve dhe mallrave; imputeve apo qëllime tjera në fushën e bujqësisë.
- **Bartja e të drejtave dhe obligimeve në rast të shuarjes apo likuidimit të Kooperativës.** Në rast të pushimit të kooperativës për shkak të shkrirjes, bashkimit apo ndarjes së saj, të drejtat dhe obligimet barten në pasardhësit e saj. Ndërsa në rastet e likuidimit gjegjësisht falimentimit të kooperativës, pas përmbushjes së të gjitha obligimeve, pasuria e mbetur i bartet njësisë së vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilës gjendet ajo e cila mund ta bartë në pronësi të ndonjë kooperative tjetër ekzistuese, kooperative të re të krijuar apo ta shfrytëzon për zhvillimin e kooperativizmit.
- **Republika e Kroacisë** - Specifikimi i shumës së kontributit aksionar me rastin e themelimit të kooperativës, pagesa e anëtarësisë si formë e krijimit të kapitalit të kooperativës si dhe kush e cakton shumen e anëtarësisë. Sipas Ligjit të Kroacisë, shuma e deponimit bazik dhe shtesë është i njëjtë ndërsa lartësinë e tij e cakton Kuvendi i Kooperativës.

**Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme**

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore.

*Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Ndikimet përkatëse të identifikuara** |
|---|---|
| Ndikimet ekonomike | Ndikim në qasjen në financa për biznes;<br>Largohen nga tregu produkte të caktuara (jo cilësore);<br>Lejohen në treg produkte të caktuara (cilësore);<br>Ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës;<br>Do të krijohen biznese të reja. |
| Ngarkesa administrative | Thjeshtësim i detyrimeve për dhënien e informatave për bizneset. |
| Tregtia | Pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit;<br>Pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit. |
| Investimet | Pritje nga kompanitë të investojnë në veprimtari të reja;<br>Rritje e investimeve nga diaspora;<br>Rritje e investimeve të huaja direkte. |
| Konkurrueshmëria | Promovim i inovacionit dhe hulumtimit. |
| Ndikimi në NVM | Kompanitë janë të prekura kryesisht NVM |
| Çmimet dhe konkurrenca | Do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin dhe konsumatorët;<br>Do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese. |
| Ndikimet ekonomike rajonale | Do të ndikohen sektorë të veçantë i biznesit. |
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | Do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike. |
| Ndikimet shoqërore | Do të rritet numri aktual i vendeve të punës;<br>Do të ketë ndikim në nivelin e pagesës;<br>Ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës;<br>Ndikim në cilësinë e ushqimit. |
| Ndikimet mjedisore | Ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve); |
| Ndikimet në të drejtat themelore | Mbrojtje ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes;<br>Parimi dhe barazia; |

| | |
|---|---|
| Administrimi i mirë | Ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj). |

## NDIKIMET EKONOMIKE

### Ndikimi në qasjen në financa për biznes

Me vendosjen e këtyre politikave apo me ndryshimin e Ligjit për kooperativat bujqësore do të synohet përmirësimi i tregut me produkte bujqësore, të cilat do të prodhohen në vendin tonë, do të shfrytëzohen më mirë sipërfaqet punuese të tokës, ndikim në rritjen dhe stimulimin e fermerëve prodhues, ndryshim në gjendjen e madhësisë së fermave dhe stabilizim i tregut me produkte bujqësore. Me këtë politikë një pjesë e produkteve bujqësore do të jenë konkurruese në treg për nga aspekti i cilësisë dhe sigurisë ushqimore, si dhe do të krijohet qëndrueshmëri, stabilitet dhe parashikueshmëri të hyrave për fermat.

### Largimi nga tregu i produkteve të caktuara (jo cilësore)

Organizimi i fermerëve vendor përmes kooperativave bujqësore, do të krijoj mundësi prodhimit të produkteve bujqësore vendore, të cilat do të ketë ndikim në minimizimin e qarkullimit dhe përdorimit të produkteve bujqësore jo cilësore të inportuara nga vende të ndryshme.

### Lejimi në treg i produkteve të caktuara (cilësore)

Lejimi i tregtimit të produkteve bujqësore do të mbetet i lirë, paraprakisht duke ju nënshtruar procedurave të kontrollit të tyre për t'i vlerësuar sipas kritereve dhe standardeve të cilësisë me qëllim lejimin e tyre për qarkullim në treg.

### Ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës

Organizimi i fermerëve përmes kooperativave bujqësore do të ketë ndikim në ngritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese për produkte bujqësore, të cilat gjatë proceseve të ndryshme nga prodhimi, përpunimi, paketimi e deri në shitje, mund të krijohen mundësi në lehtësimin e gjetjes së vendeve të ndryshme të punës.

### Krijimi i bizneseve të reja

Prodhimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore, mund të nxitë interesimin e palëve të caktuara për të prodhuar produkte të ndryshme bujqësore, të cilët mund të regjistrohen si operatorë (kompani prodhuese) për prodhimin e produkteve të caktuara bujqësore, apo mund të ketë ndikim në rritjen e numrit të fermerëve që do të jenë në shërbim të kompanive prodhuese.

### Dhënia e informatave për bizneset

Këmbimi i informatave për bizneset lidhur me organizimin dhe veprimatarive të kooperativave bujqësore, mund të krijoj lidhje bashkëpunimi, marrje e informatave rreth cilësisë së produkteve bujqësore në kooperativa, të cilat do të kenë ndikim në shit-blerjen e tyre. Po ashtu, duhet theksuar se informatat do të jenë më të thjeshtësuara, duke i informuar palët e interesit (bizneset) përmes shpërndarjes së informacioneve në forma të ndryshme elektronike, përfshirë edhe web faqet e tyre.

**Ndryshueshmëria e flukseve aktuale të importit**

Ndryshimi i fluksit të importit aktual i produkteve bujqësore, do të jetë i mundur duke i mbështetur prodhuesit vendor në organizimin e tyre përmes kooperativave bujqësore, si dhe duke i mbështetur në forma të ndryshme që mund të jenë financiare apo mbështetje tjera të cilat do të ndikonin në rritjen prodhimtarisë bujqësore në nivel vendi, e cila do të ndikoj në minimizimin e kërkesave të tregut për produkte të importuara.

**Ndryshueshmëria e flukseve aktuale të eksportit**

Mbështetja e vazhdueshme në ngritjen e kapaciteteve ndaj prodhueseve vendor, do të ketë për synim zhvillimin e fermerëve, rritjen e prodhimtarisë bujqësore, mbulimin e tregut vendor, dhe po ashtu krijimin e hapësirës në eksportimin e tyre jashtë vendit.

**Investimet e kompanive në veprimtari të reja**

Organizimi i fermerëve përmes kooperativave bujqësore do ta fuqizoj sektorin e bujqësisë në Kosovë, duke e rritur prodhimtarinë bujqësore e cila do të krijoj mundësi kompanive të ndryshme investime në veprimtari të ndryshme, varësisht nga destinimi i produkteve.

**Investimet nga diaspora**

Me hartimin e Ligjit të ri për kooperativat bujqësore në Kosovë, do të krijohen hapësira për palët që kanë për synim investimet në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në vendin tonë, të cilat mund të jenë edhe operatorë të jashtëm nga diaspora të cilët do ta kenë mundësinë e investimeve në sektorin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve të ndryshme bujqësore. Investimet e diasporës në sektorin e bujqësisë në vendin tonë do të kenë ndikim në ngritjen e standardeve të cilësisë për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore-cilësore duke u bazuar në praktikat e vendeve të ndryshme të botës nga të cilat vijnë investitorët.

**Investimet e huaja direkte**

Investimet e huaja të mëtutjeshme në sektorin e bujqësisë do të jenë të mundshme, duke e ditur se aktualisht mbulimi i tregut tonë me produkte bujqësore vendore është

i pamundshëm, andaj kjo gjendje mund të nxitë kompanitë e huaja prodhuese të realizojnë investime direkte qoftë në prodhim apo tregtim të produkteve bujqësore, të cilat në secilin aktivitet që do ta realizojnë do të paguajnë taksa në vendin tonë, njëkohësisht do të furnizohet tregu me produkte cilësore.

**Promovimi i inovacionit dhe hulumtimi**

Organizimi fillestar i organizimit të fermerëve përmes kooperativave bujqësore fillimisht do të bëhet përmes pilot-projekteve të para me një numër më të vogël të kooperativave. Në hapin fillestar do të bëhen hulumtime rreth organizimit dhe funksionimit të tyre, pastaj gjatë zhvillimit të tyre do të krijohen mundësi të investimeve në inovacion, dhe në promovimin e produkteve të tyre.

**Ndikimi në NVM**

Organizimi i fermerëve përmes kooperativave bujqësore, dhe përmirësimi i prodhimtarisë bujqësore në vendin tonë, pa dyshim do të ketë ndikim në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), duke e ditur se ato janë një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së një vendi. Ndërmarrjet e vogla të mesme luajnë një rol të rëndësishëm si në tregjet e brendshme ashtu edhe në ato ndërkombëtare, ato duhet të përmirësohen vazhdimisht, të rriten, të rrisin numrin e punonjësve, të rrisin gamën e tyre të produkteve dhe shërbimeve të tyre.

**Rritja e numrit të mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin dhe konsumatorët**

Rritja e prodhimtarisë bujqësore në nivel vendi, do të ndikoj në përmirësimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë, andaj ky përmirësim do të mundësoj rritjen e numrit të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme të cilat do të jenë në dispozicion për bizneset, por edhe për konsumatorët

**Do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese**

Përmirësimi i sektorit të bujqësisë përmes rritjes së prodhimtarisë bujqësore në nivel vendi do të arrihet përmes organizimit të kooperativave bujqësore, të cilat do të krijojnë mundësi për ruajtjen e prodhimeve bujqësore-vendore, do ta mundësojnë rritjen e konkurrencës në treg raport me produktet e inportuara, dhe mundëi uljen e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve ekzistuese.

**Do të ndikohen sektorë të veçantë i biznesit**

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë, pa dyshim do të ketë ndikim në zhvillimin e bizneseve të caktuara të cilat do të zhvillojnë veprimtari të kësaj natyre, siç është tregëtimi i inputeve të ndryshme bujqësore, por edhe tregëtimi i produkteve të prodhuara në vendin tonë.

**Ndikimi në rritjen e ardhshme ekonomike**

Furnizimi i tregut me produkte bujqësore vendore do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik në nivel vendi, fillimisht duke e ndryshuar mirëqenien e fermerëve, por me ndikim edhe hallka tjera zinxhirore, siç janë kompanitë që merren me prodhimin dhe përpunimin e produkeve dhe nënprodukteve të ndryshme, po ashtu edhe kompanitë e tregtimit të këtyre produkteve.

**NDIKIMET SHOQËRORE**

**Do të rritet numri aktual i vendeve të punës**

Organizimi i fermerëve përmes kooperativave bujqësore do të mundësoj zhvillim të sektorit të përgjithshëm të bujqësisë, i cili do të krijoj mundësi në hapjen e vendeve të reja të punës në sektor të caktuar, siç është: sektori i prodhimit, përpunimit, paketimit, marketingut, shitjes, transportit etj.

**Do të ketë ndikim në nivelin e pagesës**

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe hapja e vendeve të reja të punës në sektor të caktuar, pa dyshim që do të ketë ndikim në nivelin e pagesës, varësisht nga zhvillimi dhe vlerësimi i këtij sektori, i cili në çdo kohë do të jetë shumë i rëndësishëm për zhvillim ekonomik për secilin vend në botë.

**Ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës**

Themelimi i kooperativave bujqësore, pa dyshim do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës duke angazhuar fermerë të rinj, punëtorët brenda kooperativave të cilët do të punojnë në pozita të ndryshme.

**Ndikim në cilësinë e ushqimit**

Produktet e fituara nga fermerët anëtarë të kooperativave bujqësore do të kenë për synim plotësimin e nevojave për popullatën, dhe po ashtu çdoherë do të jenë të kontrolluara për cilësinë e tyre. Andaj, sigurimi i ushqimit primarë nga produktet bujqësore dhe siguria e tyre, do të ndikoj në shëndetin e përgjithshëm publik i cili është interes nacional në vendin tonë.

**NDIKIMET MJEDISORE**

**Ndikim në cilësinë e tokës**

Kooperativat bujqësore në BE dhe vende të rajonit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në informimi i fermerëve për masat që duhet ndërmarr për ruajtjen e ambientit. Përmes trajnimeve ata arrijnë të kenë ndikim në edukimin e fermerëve për përdorimin

e preparateve të ndryshme kimike, dhe pajisjeve që kanë ndikim direket në ruajtjen e mjedisit, me fokus të veçantë, ruajtjen në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve në përgjithësi.

**TË DREJTAT THEMELORE**

**Mbrojtje ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes**

Fermerët e Kosovës sot përballen vazhdimisht me praktika të padrejta tregtare. Zhvillimi i sektorit të kooperativave bujqësore do të ndikonte që fermerët të kryejnë aktivitetin e tyre ekonomik me më shumë dinjitet dhe të kenë të ardhura më stabile për të siguruar jetësë më të qëndrueshme.

**Parimi dhe barazia**

Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore do të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjitha palët.

**Ndikimi në të drejtat themelore dhe administrimi i mirë**

Me përmirësimin e kësaj politike, procedurat administrative do të jenë më transparente, do të eliminohen procedurat e tepërta burokratike dhe të përcaktohen afatet procedurale për zgjidhjen e lëndëve.

**Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave**

Gjatë hartimit të Koncept Dokumentit për farëra, jemi shërbyer me të dhëna të cilat burim të informacionit kanë Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, Regjistrimin e fundit të Bujqësisë të vitit 2019, 2020 dhe 2021 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Raportit të Gjelbër 2021.

Meqenëse sigurimi i të dhënave nga fusha e bujqësisë realizohet me vështirësi, veçanërisht si anketa ku përfshihen brenda vitit rreth 4 deri 5 % të numrit të përgjithshëm të ekonomive familjare të Kosovës, ndërsa regjistrimi i bujqësisë realizohet çdo 10 vite, mund të themi se këto të dhëna nuk i plotësojnë kërkesat për analiza më të detajuara dhe të sakta. Të dhënat ekzistuese nuk mund të përfaqësojnë me këtë përqindje të ulët gjendjen reale të ekonomive familjare bujqësore.

Agjencia e Statisikave të Kosovës është gjeneruesi më i autorizuar i të dhënave, ku çdo vit realizon anketën për ekonomi familjare bujqësore me metodën e zgjedhjes së rastit, duke përfshirë rreth 4-6% e ekonomive familjare bujqësore ekzistuese. Ndërsa, çdo 10 vite parashihet të organizohet regjistrimi i bujqësisë.

Të dhënat e raportit të Regjistrimit të Bujqësisë për shfrytëzimin e tokës që realizohen çdo 10 vite, përfshijnë regjistrimin e të gjitha variablave të shfrytëzimit të tokës së ekonomive familjare, si: sipërfaqet, struktura e kulturave bujqësore, rendimentet,

masat agroteknike siç është ujitja dhe trajtimi me plehera e pesticide, etj. Ndërsa, të dhënat e anketave edhe pse realizohen çdo vit, nga përqindja e ulët e përfshirjes së ekonomive bujqësore në anketë nuk mund të themi që janë reprezentative.

Regjistrimi i Bujqësisë që realizohet në bashkëpunim të MBPZHR-së dhe ASK-së, mbetet burimi më i besueshëm i të dhënave të shfrytëzimit të tokës dhe përdorimit të imputeve bujqësore.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

[Listoni këtu palët kryesore të interesuara, që janë identifikuar në Figurën 4 nga Kapitulli mbi Përkufizimin e Problemit. Listoni konkluzionet kryesore që pasuan nga aktivitetet e konsultimit në tekst. Listoni të gjitha aktivitetet e konsultimit që janë kryer në tabelën më poshtë. Bashkëngjitni shtojcat mbi aktivitetet e konsultimit dhe komunikimit, siç janë njoftimet për shtyp, raportet nga ngjarjet, etj. Nëse disa palë të interesuara nuk janë konsultuar, shpjegoni pse. Nëse palët e interesuara shumë të rëndësishme u ftuan të marrin pjesë në aktivitetet e konsultimit, por nuk morën pjesë, deklaroni për cilin rast është dërguar ftesa e që pala nuk mori pjesë. Gjithashtu shpjegoni se çfarë veprimesh të tjera janë ndërmarrë për të parë nëse palët e interesuara do të jenë në gjendje të përfshihen në aktivitetet e konsultimit.]

*Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument*

Procesi i konsultimit synon:

- [jepni informacionin këtu]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet.]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, titulli i kolonës 'Afati Indikativ' duhet të ndryshohet në 'Afati kohor'.]

| Qëllimi kryesor | Grupi i synuar | Aktiviteti | Komunikimi/ njoftimi | Afati indikativ | Buxheti i nevojshëm | Personi përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara | Të gjitha palët e interesuara | Takim publik | E-mailit | 13.09.2023 | MBPZHR | Tahir Halitaj |
| Konsultimi publik me shkrim | Të gjitha palët e interesuara | Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik | | | | |
| | | | | | | |

**Përmbledhje nga aktivitetet publike për Koncept Dokumentin**

1. Organizimi fillestar me palët me interes është mbajtur me datë: **13.09.2023**, ndërsa në takim kanë marr pjesë përfaqësuesit nga MBPZHR - DSHKT, dhe palë tjera të interesit nga shoqata dhe organizatave të ndryshme, që ishin: AgroDev, Swiss Caritas, PePeKo, Mjedra e Kosovës, Shoqata Organika dhe IADK.
   Ftesës për pjesëmarrje i është përgjigjur edhe Organizata PPSE e cila përmes mbështetjes së saj i ka krijuar mundësi Ekipit Punues për hartimin e Draft Koncept Dokumentit për Kooperativat Bujqësore, t'i realizoj dy vizita studimore jashtë shtetit të Kosovës, njërën në Republikën e Maqedonisë Veriore dhe tjetrën në Republikën e Italisë. Vizitat kishin për qëllim, marrjen e praktikave më të mira nga kooperativat bujqësore të këtyre dy vendeve.
   Grupi punues ka prezantuar para pjesëmarrësve fillimin e punës së Draft Koncept Dokumentit, i cili ka për qëllim krijimin e një politike të mirëfillt, e cila do t'i krijoj mundësi fermerëve organizimin e tyre përmes kooperativave bujqësore, të cilat do t'ju krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin e tyre, dhe sektorit të përgjithshëm të bujqësisë në nivel vendi.
